



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor  
në “Gjuhë Greke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim  
grek, përkthim dhe interpretim”  
i  
Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.As. Dr. Konstantinos Giakoumis
2. Dr. Kostando Ksera

Janar 2023

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor”**  
**në “Gjuhë Greke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek, përkthim dhe interpretim”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës Greke
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Gjuhë Greke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek, përkthim dhe interpretim
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Vendim MASH Nr. 258, datë 01.12.1998.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 297, dt. 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	I
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip dhe Greqisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	2018-2021: 81 studentë; 2018-2019: 17 st. në v. I; 2019-2020: 4 st. në v. I; 2020-2021: 6 st. në v. I
19	Komente / të tjera:	-

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës; (200 - 400 fjalë)

Programi në proces të vlerësimit të jashtëm Bachelor në “Gjuhë Greke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek, përkthim dhe interpretim” (Niveli 6 në kornizën shqiptare dhe europiane të kualifikimeve) është licensuar me VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. Edhe pse programi ka lëshuar diploma qysh prej vitit 2020, ky është vlerësimi i parë i tij për akreditim. Programi organizohet në tri vite studimi, me 180 ECTS nga Departamenti i Gjuhës Greke, i cili operon brenda Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës. Forma e studimit është me kohë të plotë, me prani fizike para dhe pas pandemisë, ndërsa gjuhët e instruksionit janë greqishtja dhe shqipja. Staf i akademik në shërbim të këtij programi studimi përbëhet nga shtatë (7) anëtarë të brendshëm, me kohë të plotë (një anëtar i shkëputur për arsye të interesit kombëtar) dhe pesë (5) pedagogë të jashtëm.

Misioni i programit të studimit është të krijojë, zhvillojë, përcjellë dhe mbrojë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; të formojë specialistë të nivelit të lartë në fushën e gjuhës dhe qytetërimit grek në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; të krijojë mundësi për aftësimin human dhe edukues të studentit. Orientimi i këtij misioni është drejt formimit të aftësive shkencore, teorike dhe praktike, pedagogjike dhe gjuhësore për të përgatitur mësimdhënës dhe përkthyes me standarde të larta.

Studentët e programit që GVJ-a intervistoi vijnë kryesisht nga familje emigrantësh nga Shqipëria në Greqi.

## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Grupi i vlerësimit të jashtëm ndoqi metodën e standardizuar në manualet dhe praktikat e ASCAL-it, të strukturuar në tri faza faza e punimit në zyrë, faza e verifikimit në terren dhe faza e përfundimit të vlerësimit dhe hartimit të RVJ-së.

Përfaqësuesja e ASCAL për këtë program vlerësimi është Znj. Endra Velaj.

### • Faza I: Trajnimi i Ekspertëve dhe Studimi i RVB-së

Pas krijimit të Grupit të Punës, ekspertët e jashtëm u ftuan në një seancë trajnuese në ambientet e ASCAL-it dhe plotësuan pjesën kontraktuale të punësimit të tyre. Pas dorëzimit të RVB-së së bashku me evidencat shoqëruese të tij, ekspertëve të jashtëm u akordua kohë e mjaftueshme për ta studiuar atë, me synimin që të formohej një pamje sa më e qartë mbi programin e studimit nën vlerësim, pikat e forta dhe pikat që paraqisnin nevojë verifikimi në terren. P.sh. ndërsa përputhja e misionit të programit me misionin e Departamentit, Fakultetit dhe Institucionit prej të cilit programi ofrohet ishte i qartë, numri i pedagogëve të brendshëm paraqitej të ishte jo-konform parashikimeve ligjore, rrjeshimisht u shënua si pikë për verifikim në terren.

### • Faza II: Verifikimi në Terren

Pas përcaktimit të datave dhe axhendës së vizitës dy-ditore në institucionin ofrues të programit të studimit nën vlerësim për akreditim, GVJ-a, i shoqëruar nga koordinatori i caktuar nga ASCAL, kreu vizitën për të ballafaquar gjetjet e fazës I me realitetin në terren. Aty, u realizuan si inspektimi i ambjenteve që përdor programi, ashtu edhe një sërë takimesh:

1. Me Dekanin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, për t' marrë mendimin mbi këtë program studimi, perspektivat e tij dhe rolin e Departamentit ofrues në strategjinë e zhvillimit të fakultetit, si edhe me drejtuesin e departamentit mbi këto objektiva.
2. Me GVB-në, për të verifikuar gjithëpërfshirjen, lirinë e veprimit dhe gjykimin të tij, si çfarë ka mësuar në procesin e vetë-vlerësimit dhe si qëllohet të kapitalizohet mbi njohuritë e përfutuara në këtë poces.
3. Me personelin akademik të programit të studimit për të verifikuar nivelin e përhapjes së kulturës të cilësisë që përshkruhet në RVB.
4. Me studentët e programit të studimit për të vertëtuuar përfshirjen e tyre në procesin e vlerësimit të brendshëm, nivelin e pjesëmarrjes së tyre në çështjet me interes studentor të departamentit, si edhe për të konstatuar nivelin e efikasitetit të proceseve të komunikimit të departamentit me studentët e tij dhe nivelin e fuqizimit të tyre. Përfshirja edhe e një studenteje të diplomuar brenda ciklit të vlerësimit, i dha mundësinë GVJ-së për të parë 'produktin' e programit të studimit, për të konstatuar nivelin e përmbushjes së misionit të programit.
5. Me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, për të vertëtuuar nivelin e ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të tij në monitorimin e kulturës së cilësisë në këtë program studimi.
6. Me Zyrën e Kurrikulave, për të konstatuar sesa thellë shkon roli i saj në rishikimin e kurrikulave të programit.

7. Me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë të Fakultetit për të parë rolin dhe kontributin e departamentit të programit të studimit nën vlerësim në të.
8. Me instanca të mbështetjes administrative (Burime Njerëzore dhe Sekretaria Mësimore) për të parë nga afër mënyrën e operimit të tyre në funksion të këtij programi studimi.

- **Faza III: Finalizimi i RVJ-së**

Sinteza e gjetjeve të dy fazave të para u krye në këtë fazë të tretë, duke marrë parasysh edhe evidencat – shtesë që u dorëzuan nga institucioni pas kërkesës së GVJ-së.

Koha dhe kushtet qenë të mjaftueshme për të krijuar një opinion të mire-evidentuar për të hartuar një raport objektiv, të mbështetur në evidencat e paraqitura apo të gjeneruara gjatë gjithë këtyre fazave.

Me datë 19/12/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/179, Datë 19/12/2022, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS me datë 05/01/2023 dhe me shkresë zyrtare Nr. 2104, Datë 22/12/2022.

**GVJ pasi u njoh me komentet e bëra nga Universiteti i Tiranës (në vijim shkurt UT) lidhur me draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, sqaron si më poshtë:**

**Mbi komentet e Departamentit të Gjuhës Greke lidhur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë Greke me profil gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek”**

GVJ pasi u njoh me komentet e bëra nga Departamenti i Gjuhës Greke lidhur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm sqaron si më poshtë:

Departamenti me komentet që paraqiti mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm vërteton edhe një herë opinionin që ka krijuar GVJ-ja se është i vetëdijshëm për situatën në të cilën ndodhet dhe se do të reflektojë për përmirësimin e saj. Këtë e vërtetojnë në përgjithësi të gjitha përgjigjet e tij mbi pikat e dobëta, si dhe reagimi i tyre për të marrë masa përmirësuese.

Pikat që duan një sqarim nga ana jonë janë:


1. Në lidhje me “Pjesëmarrjen e studentëve...” GVJ për konkluzionet e tij është bazuar në evidencat në dispozicion si dhe në vizitën në institucion, ku u takua me dy studentë.
2. Në lidhje me pasurimin e bibliotekës vlen e njëjta gjë. Përveç listës së teksteve nga Fondacioni Onasis të cilën e kishim në dispozicion, nuk kishim evidencat tjera që të na bindnin se ekziston një strategji për pasurimin e bibliotekës si dhe për shfrytëzimin më efikas të saj nga ana e studentëve.

Si lista e blerjeve të reja, ashtu edhe lista e fondit të librave në gjuhën greke të bibliotekës që u bashkangjiti me komentet, duhet theksuar se nuk paraqesin ndonjë bibliografi shteruese për profilin e këtij programi studimi, i cili shtrihet njëkohësisht në fusha shkencore të ndryshme siç janë gjuha, letërsia dhe kultura greke, mësimdhënia e gjuhës dhe përkthimi.

Akoma më shumë që pika e dobët e vetme që vet GVB ka paraqitur në RVB është “Paturimi i bibliotekës fizike dhe mundësimi i një biblioteke on-line”

Në lidhje me mungesën në stafin akademik me kohë të plotë, institucioni ka reflektuar dhe ka vënë në dispozicion të GVJ kërkesën e departamentit për një anëtar të ri, miratim e kritereve si dhe shpalljen e vendit vakant.

**Si përfundim, GVJ i përmbahet vlerësimeve dhe rekomandimeve që ka dhënë në Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.**



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në**  
**“Gjuhë Greke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek, përkthim dhe**  
**interpretim”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Në shtjellimin e këtij kriteri RVB-ja argumentoi se programet e ofruara prej institucionit jo vetëm që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, por edhe u vihen në shërbim të këtyre interesave kombëtare. Për pjesën e parë, institucioni tregoi bindshëm ligjshmërinë e programeve të studimeve të ofruara, përfshi edhe programi konkret studimi nën vlerësim ( <i>VKM Nr. 418/10.05.2017 “Për hapjen e programit të studimit” nën vlerësim</i> ). Në pjesën e dytë, edhe pse RVB-ja nuk emëroi interesat kombëtare që i shërbejnë programet e studimit të institucionit, argumentet e përdorura për të treguar se “Universiteti i Tiranës synon të angazhohet në transformimin e jetës së studentëve dhe të shoqërisë” ( <i>RVJ, bazuar në Evidencë 1.1, neni 4 &amp; 5 Statuti i UT</i> ) dhe se Fakulteti dhe Departamenti me programin e tij bashkërenditen në shërbim të këtij synimi ( <i>Evidencë 1.5, fq. 3 Strategjia e Zhvillimit të FGJH-së dhe Evidencë 2.1.1, neni 1 Rregullore e Programit të studimit Bachelor në gjuhë greke</i> ) ishin bindëse.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Evidencat në mbështetje të këtij kriteri në RVJ-në ishin Statuti ( <i>Evidencë 1.1, neni 4, neni 8 Statuti i UT</i> ), Strategjia e zhvillimit institucional ( <i>Evidencë 1.2, pika 2.1.1 dhe 2.1.7</i> ) dhe Rregullorja e FGJH ( <i>Evidencë 1.8, neni 3</i> ). Duke qenë se asnjë evidencë prej këtyre nuk argumenton konkretisht për këtë program studimi, GVJ-ja instistoi në këtë pike gjatë vizitës në institucion. Në takimin me pedagogët e programit të studimit ( <i>Minutat Gjuha Greke, f. 4 dhe passim</i> ) artikulumet e interesave konkrete kombëtare, të cilave i shërben programi i studimit nën vlerësim, del në mënyrë më rrjedhëse si në RVB. Pedagogët e programit të studimit ishin të ndërgjegjshëm për rolin e programit të studimit në ruajtjen e vlerave të gjithpërfshirjes, si edhe në përgatitjen e personave që, me thellimin e duhur, mund të shërbejnë si specialistë në fusha specifike të trashëgimisë kulturore Greke në Shqipëri. Për më tepër, në RVB, GVB-ja deklaroi se programi synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike të “përgatitjes së specialistëve në një formim gjuhësor dhe shkencor me drejtim human.” Edhe pse nuk jepen evidencat mbështetëse, GVJ ka gjetur evidencat në mbështetje të këtij pohimi në intervistat e studenteve, të cilat folën për përkujdesje të mirë individuale sipas nevojave personale nga pedagogët e tyre ( <i>Minutat Gjuha Greke, f. 49-11</i> ), element i domosdoshëm në drejtimin ‘human’ në çdo program studimi.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje	Sipas RVB-së, “programet e studimit në UT kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë

me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<i>e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente” (Evidencë 1.2 Strategjia e Zhvillimit UT 2018-2023, pika 4, fq. 17).</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit është hartuar me të njëjtin synim (Evidencë 2.1.1, Rregullore e Programit të studimit Bachelor në gjuhë greke, neni 3), mirëpo mungesa e parashikimit për praktika profesionale të studentëve të programit të studimit disi dobëson këtë pohim, ndërsa praktika të tilla, përpjekje për t’i siguruar dhe vlerësimi i tyre mund t’i jepte departamentit një shans për të matur nivelin e realizimit të këtij synimi. Shtojca 1.12 “Studim Tregu Pune” që premtonte evidenca në këtë drejtim nuk i përket programit të studimit nën vlerësim. Megjithatë, pohimet e kryesisë së departamentit dhe pedagogëve për nivele të larta punësimi të të diplomuarve konfirmohen empirikisht nga GVJ-ja.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>				
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Strategjia e zhvillimit të institucionit ofruet të programit të studimit nën vlerësim përcakton fushat e përgjithshme dhe specifike, synimet, kompetencat dhe vlerat që duhen promovuar në secilin program studimi të ofruar prej tij (Evidencë 1.2, Strategjia e Zhvillimit UT 2018-2023, f. 4, 6, 17). Programi i studimit nën vlerësim është hartuar në përshtatje dhe në zbatim të këtyre parimeve strategjike (Evidencë 2.1.1, Rregullore e Programit të studimit Bachelor në gjuhë greke, neni 3.2).			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në RVB deklarohet se "në Statutin e UT-së, përcaktohen drejtimit prioritar akademike të institucionit" dhe citohet, në mënyrë të tërthortë, Neni 5 (Evidencë 1.1 Statuti i UT, neni 5), i cili i referohet misionit të institucionit. Neni 102 parashikon ofrimin e programeve të mësuesisë. Rregullorja e programit të studimit është e bazuar në përcaktimet institucionale (Evidencë 2.1.1, Rregullore e Programit të studimit Bachelor në gjuhë greke neni 3.2 dhe 6).			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Rrjedhimisht, edhe emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit «Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek» janë në përputhje të plotë me fushat e drejtimit akademike të institucionit, fakultetit dhe të departamentit që e ofron.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi I.3**

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Objektivat e përcaktuara në programin e studimit nën vlerësim përfshijnë dije edhe aftësi që duhen fituar prej studentëve deri në përfundim të studimeve të tyre, në përputhje me profilin e programit, përmenden në rregulloren e programit të studimit (<i>Evidencë 2.1.1. Rregullore e Programit të studimit Bachelor në gjuhë greke, Neni 3</i>). Komenti i RVB-së se “zhvillimi i kompetencave paraqitet kryesisht në Objektivat Nr. 6 dhe 7” (<i>RVB, 13</i>) nuk paraqitet plotësisht bindës, sepse formulimi i objektivave (<i>Objektiva 6: Njohja me teknikat... metodat... problematikat; Objektiva 7 (pjesë): Aftësimi për njohjen dhe zbatimin...</i>) i referohet në rastin më të mirë synimeve dhe jo kompetencave. GVJ-ja ballafaqoi objektivat me plan-programet e programit të studimit (<i>Evidenca 2.1.6, Silabuset, 2021-2022\Viti i trete 2021-2022, passim; p.sh. 13-7, 66-71</i>), ku vihet re se përqëndrimi është tek njohuritë dhe tek të fituarit aftësi profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>FGJH ka kryer studimin e tregut të punës për studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (<i>Evidenca 1.12, Studimi i tregut e punës për studentët e gjuhëve të huaja 2021</i>), mirëpo, siç u konstatua gjatë vizitës (<i>Minutat Gjuha Greke, Dita 1, f. 9</i>), studimi i përkiste programeve Master dhe jo Bachelor, pasi këta të fundit nuk parashikojnë praktika (<i>krhs. Aneks-Tabelat permbledhese, Nr. 5</i>). Edhe pse pedagogët dispononin të dhëna empirike mbi punësimin e disa prej të diplomuarve të programit dhe kishin filluar t’i grumbullonin, kërkohet një studim më sistematik i tregut të punës, pas atij që u krye gjatë hapjes së programit të studimit, me të dhëna të reja, pas pandemisë. GVJ-ja u bind se aktorët përgjegjës të programit të studimit (drejtuesi i departamentit dhe pedagogët) janë të ndërgjegjshëm dhe se grumbullimi i të dhënave ishte pikërisht në këtë kudër.</p> <p><b>Sugjerim:</b> Një studim më sistematik i tregut të punës, pas atij që u krye gjatë hapjes së programit të studimit, me të dhëna të reja, pas pandemisë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënimit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Përpos mospërdorimit të termit ‘kompetencë,’ objektivat e vendosura si në rregulloren (<i>Aneks 1.8 Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja</i>), ashtu edhe në zberthimin e saj në planet mësimore (<i>silabuset, Aneks 2.1.6 Syllabuset</i>), anojnë më tepër tek konteksti, zbatimi i dijes dhe disa aspekte të zhvillimit konjitiv të studentëve dhe kompetencat praktike (p.sh. kompetenca ndërpersonale, të të punuarit në grupe, të të dizenuarit të projekteve) dhe kultivimi i sjelljeve (p.sh. ndërgjegjësimit etik në zbatimin e profesionit) dhe vlerave (p.sh. përgjegjësia personale) të përshtatshme. Intervistat me GVB-në (<i>Minutat Gjuha Greke, Dita 1, f. 3</i>), studentët (<i>op. cit., Dita 1, ff. 9-10</i>) dhe pedagogët (<i>op. cit., Dita 1, ff. 5-6</i>) treguan se punohet edhe në drejtimet e mësipërme, por në mënyrë jo fort të ndërgjegjësuar. Rrjedhimisht, puna përkatëse nuk reflektohet në plan-programet lëndore.</p>

	<b>Sugjerim:</b> Sugjerohet, pas një procesi trajnimi dhe reflektimi, të pasurohen objektivat e programit të studimit dhe rrjedhimisht, edhe objektivat e lëndëve të tij me kompetenca të shumëllojshme.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Në <i>Aneks Tabelën Nr. 1 (të korrigjuar)</i> , Departamenti që organizon programin e studimit nën vlerësim deklaroi 3 pedagogë me titullin “Prof. As.”, 2 me gradën “Dr.”, 1 doktorant dhe një asistent si anëtarë i brendshëm i personelit akademik, ndërsa personeli akademik i jashtëm është vetëm me kualifikimin Master Shkencor dhe ato punësohen si personel ndihmës akademik. Ndërkohë që përvoja (me tre pedagogë në mesin e karrierës së tyre akademike) paraqitet e mjaftueshme dhe kualifikimet e pedagogëve janë të duhura ( <i>Evidenca 2.1.7, CV, stafi akademik dhe ndihmes akademik</i> ), bie në sy mungesa e gradave dhe titujve të personelit akademik me kontratë. Aty, drejtuesit e departamentit dhe të Fakultetit deklaruan mungesë personeli me grada dhe tituj në këtë fushë në Shqipëri, si dhe mbylljen e doktoratave për një kohë të gjatë; arsye që qëndrojnë sipas GJV-së.
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Shkëputja e një anëtari të personelit akademik në shërbim të interesit kombëtar dhe ruajtja e pozicionit, sipas ligjit, krijoi ngarkesa të mëdha për stafin ekzistues ( <i>Aneks-Tabelat permbledhese, Tabela Nr. 4</i> ): <ul style="list-style-type: none"> <li>• Anëtar Nr. 1 (drejtues departamenti / Prof. As.): 230 orë / vit.</li> <li>• Anëtar Nr. 2 (Prof. As.): 230 orë / vit.</li> <li>• Anëtar Nr. 3 (Dr.): 430 orë / vit në tetë (8) lëndë.</li> <li>• Anëtar Nr. 4 (Dr.): 300 orë / vit.</li> <li>• Anëtar Nr. 5 (Dr.): 320 orë / vit në shtatë (7) lëndë.</li> <li>• Anëtar Nr. 6 (Asistente lektore): 350 orë / vit në nentë (9) lëndë.</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitet	Saktësia e këtyre të dhënave u konfirmua jo vetëm nga vetë pedagogët, por edhe në diskutime me zyrën e burimeve njerëzore dhe administratorin e Fakultetit ( <i>Minutat Gjuha Greke, Dita 1, ff. 19-21 të dokumentit</i> ). Këto ngarkesa, edhe pse, deri diku, të justifikueshme sipas Udhezimit Nr. 29, 10.09.2018 të Ministrisë së Arsimit për ngarkesat mesimore, të ndryshuar, me numrin e vogël të studentëve dhe në rrethanat e përshkruara më sipër, nuk krijojnë kushte favorizuese për një mësimdhënie me cilësi sa më të lartë. GVJ-ja konstatoi se Departamenti, i ndërgjegjshëm për këtë situatë, mori masa për hapjen e një vendi vakant për zëvendësimin e anëtarit të shkëputur. Ky fakt, sipas GJV-së tregon një nivel vigjilence të vetë Departamentit në aspekte të rëndësishme të cilësisë.


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 10



bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<p>Evidencat e paraqitura (<i>Evidenca 1.8. Rregullore e FGJH-së, Neni 2 dhe Evidenca 2.1.1 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Greke, Neni 2, Neni 3</i>), së bashku me intervistën e drejtuesve të kërkimit shkencor dhe projekteve të Fakultetit (<i>Minutat Gjuha Greke, ff. 17-9</i>) e bindën GVJ-në se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore si të njësisë kryesore, ashtu edhe të asaj bazë.</p> <p><b>Sugjerim:</b> Të reduktohen ngarkesat e larta mësimore për të krijuar kushte favorizuese për një mësimdhënie me cilësi sa më të lartë.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi I.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Institucioni parashikon marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive të personelit. GVJ ka verifikuar se parashikimi është funksional, duke kontrolluar mënyrën sesi ofrohet Gjuha C, Anglishtja (5 dhe 6) (<i>Aneks 2.1.6 Syllabusët, 2021-2022, Viti i trete 2021-2022, 26-31 dhe 85-90</i>). Silabët përkatës i firmos drejtuesi i departamentit të gjuhës angleze; element ky, që dëshmon marrjen e përgjegjësive respektive. Megjithatë, na bëri përshtypje fakti që të dy silabët janë identikë në formë dhe në përmbajtje, edhe pse në hyrje mbartin emërtesat e sakta të dy lëndëve respektive, dëshmi se kontrolli dhe analiza e punës së personelit të ftuar në këtë rast nuk kanë qenë rigorozë.</p> <p><b>Sugjerime:</b> 1. Të rishikohen gjithë syllabusët. 2. Të rritet niveli i kontrollimit dhe analizës së punës që kryen personeli akademik i ftuar nga departamente të tjera.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	<p>Institucioni ka listuar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe jashtë vendit, ndër të cilat edhe me institucione në Greqi, si Universiteti Aristotelian i Selanikut (<i>Evidenca 1.14. Marrëveshje të UT-së me kompani dhe institucione të tjera; Seria e evidencave gjatë vizitës: Marrëveshje Mobiliteti</i>). GVJ-ja ka konstatuar se marrëveshjet janë funksionale si për pedagogët (<i>Sëria e evidencave gjatë vizitës: Mobilitet i Pedagogut</i>), ashtu edhe për studentët (<i>Sëria e evidencave gjatë vizitës: Mobilitet Studenti me ERASMUS+</i>). Madje, bashkëpunime të tilla shtrihen edhe në financimin e projekteve kërkimore – kulturore në fushën e përkthimeve (<i>Evidenca 1.11. Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera 2020-2021, pika 2.2</i>).</p>
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e	<p>Të dhënat e raportuara në RVB (<i>Evidenca 1.10 Raporti Vjetor 2019-2020, f. 3 dhe Evidenca 1.11 Raporti Vjetor 2020-2021, f. 7</i>) i përkasin njësisë</p>

<p>studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>kryesore dhe jo asaj përgjegjëse për programin e studimit. Sigurisht, raporti vjetor i Fakultetit ka marrë parasysh të dhëna edhe nga Departamenti i Gjuhës Greke, mirëpo nuk paraqiten vlerësime konkrete mbi dobinë e marrëveshjeve në shërbim të departamentit dhe të këtij programi studimi.</p> <p><b>Sugjerim:</b> Të kryhen periodikisht vlerësime konkrete mbi dobinë e marrëveshjeve në shërbim të departamentit dhe të këtij programi studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Departamenti nuk parashikon praktika në programin e studimit të ciklit të parë të Arsimit të Lartë (<i>Shtojca 2.1.8 Planet mësimore</i>), duke ndjekur, në këtë mënyrë, politikat institucionale të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Rezultatet e studimit të tregut të punës dhe të studentëve të nivelit Master të anketuar, tregojnë që praktika nuk realizohet në nivel Bachelor. (<i>Dokumenti 1.12. Studimi i tregut të punës, ff. 18, 41-42</i>) dëshmon për një përqindje të lartë studentësh (28%), të cilët do të donin të kishin praktika profesionale për aftësimin e tyre, që nuk janë pjesë e studimeve të institucionit (<i>op. cit., ff. 41-43</i>). GVJ-ja është i mendimit se gjetjet të tilla duheshin trajtuar urgjentisht me masa korigjuese. Edhe pse me vonesë, intervistat me instancat drejtuese të Fakultetit dhe Departamentit, si edhe të Zyrës së Karrierës dëshmuar një nivel ndërgjegjësimit dhe nisjen e diskutimeve kolegjiale për ndërhyrje të tilla. GVJ-ja është e kënaqur për përfshirjen edhe të personelit akademik në diskutime të tilla, me ndryshime strukturore.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjeshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni nuk raporton trajnime profesionale të mëtjeshme për të diplomuarit e tij, në bashkërendim me punëdhënësit, edhe pse gjetjet nga studimi i tregut të punës duhet ti kishin gjeneruar si objekt studimi dhe planifikimi.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	


<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR


### Standardi II.1

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
------------------------	--------------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ-ja konkludoi se kriteri përmbushet. Programi i studimit organizohet në lëndë e module sipas kuadrit vendas normativ dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të Kredive (ECTS), gjë që vertëtohet jo vetëm nga rregullorja e tij (<i>Evidenca 2.1.1, Rregullore e programit të studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim grek, Neni 4</i>), por edhe nga planet mësimore që tregojnë se si zbatohet rregullorja (<i>Shtojca 2.1.8 Planet mësimore</i>). GVJ-ja ka vertëtuar gjatë vizitës te sekretaria mësimore se këto parashikime janë të lidhura me sistemin e menaxhimit të studimeve dhe paraqiten në të dhënat që disponon sekretaria.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>RVB-ja deklaroi se programi Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Greke ofron “baza të forta teorike në disa lëndë hyrëse/të përgjithshme” kryesisht në vitin I të studimeve, së bashku me “lëndë të specializuara në fusha shkencore si Gjuhësia, Përkthimi, Letërsia, Historia dhe Kultura” (<i>Evidenca 2.1.1, Rregullore e programit të studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim grek, Neni 4; Evidenca 2.1.8. Plani mësimor</i>). Gjithashtu, RVB-ja pohon se shprehi të veçanta “në fushën e gjuhës dhe letërsisë greke formohen përmes zhvillimit të [një sërë lëndësh] karakterizuese” (<i>Evidenca 2.1.6. Syllabus, Sociolinguistikë; Letërsi e Re Greke; Përkthim II; Histori dhe Qytetërimi Grek</i>). GVJ-ja vëren se mungesa e praktikave e privon departamentin që organizon programin e studimit nën vlerësim nga mundësia për të marrë të dhëna që mund t’i jepnim departamentit informata për vlerësimin e programit në tregun e punës dhe vlerësimin e tregut të punës për kompetencat e përfituara nga të diplomuarit të programit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ-ja gjykon se argumentimi i RVB se programi i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca, është përgjithësisht bindës. Arsytimi bazohet në evidenca nga lëndë të ndryshme, duke cituar edhe planet mësimore të tyre (<i>Evidenca 2.1.6. Syllabus, lënda të përkthimit shqip-greqisht dhe greqisht shqip</i>). Nga ana tjetër, mungesa e praktikës mësimore, siç u tha edhe më sipër, nuk kontribuon në zhvillimin e kompetencave profesionale.</p> <p>Për më tepër, publikimi i dijes në zhvillimin e lëndëve të gjuhës angleze, që u shtjellua më sipër, si edhe trajtimi i gjuhës angleze, gjuhë-urë për terminologjinë dhe teknologjinë ndërkombëtare përkthimore, si një nga gjuhët pasive (ndër shumë të tjera) të programit të studimit (<i>Shtojca 2.1.8 Planet mësimore</i>), sipas mendimit të GVJ-së nuk ndihmon shumë në zhvillimin e kompetencave të avancuara akademike dhe profesionale.</p> <p><b>Sugjerim:</b> Të shikohet në instancat kompetente kolegjiale dobia e mundshme e trajtimit të gjuhës angleze si gjuhë e dytë aktive, për arsye të rëndësishme të saj në zhvillimin e kompetencave të avancuara akademike dhe profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse</p>	<p>Programi i studimit përgjithësisht i përmbahet elementeve që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuar në <i>VKM-në Nr. 41 / 24.01.2018, të ndryshuar</i>, si edhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Përpos elementit të theksimit të kompetencave në objektivat mësimore që u prek më lartë, programet e lëndëve jo gjithmonë u përmbahen të gjitha përcaktimeve nënligjore. Në ndonjë rast mungonin referenca konkrete të</p>



dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	studimeve të studentëve për çdo temë (p.sh. Evidenca 2.1.6 Syllabusët, Viti i dytë 2019-2020, ff. 58-67), në ndonjë rast tjetër literatura bazë ishte në mënyrë të dukshme jashtë kontekstit lëndor (p.sh. Evidenca 2.1.6 Syllabusët, Viti i tretë 2021-2022, ff. 1-6). GVJ-ja evidentoi një nivel të kënaqshëm ndërgjegjësimit tek instancat e ndryshme të programit të studimit (kryesisht te drejtimi dhe pedagogët) për një proces tërësor të rishikimit të planeve lëndore.			
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	<b>Sugjerim:</b> Të rishikohen me rigorozitet dhe procedurat e vlerësimit për plan programet lëndore.			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Kurrikula e programit të studimit (Aneks-Tabelat përmbledhese, Tabela Nr. 9) përmban aktivitete formuese të mirëpërcaktuara dhe grupon lëndët/modulet sipas kategorive të parashikuara në VKM-në Nr. 41 / 24.01.2018, të ndryshuar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Ndërsa kriteret për menaxhimin e cilesisë nga institucioni dhe nga instancat përgjegjëse preken në një seksion tjetër, programi i studimit u licensua me Vendimin Nr. 258 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, datë 01.12.1998 dhe aplikimi për akreditimin e parë u krye më 27.10.2021, ndërkohë akreditimi institucional u krye më 27.10.2018 me rezultat pozitiv me afat katërvjeçar ri-akreditimi. Për sa më sipër, rezulton se afatet e vlerësimit dhe akreditimit që përcakton Pika 3 i Nenit 104 i Ligjit Nr. 80 / 2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë nuk u ndoqën, siç nuk u ndoqën edhe afatet e Pikës 3, Neni 62, i Ligjit 9741 / 2007 të mëparshëm për Arsimin e Lartë, të ndryshuar. GVJ-ja e kupton nga ana tjetër, se përgjegjësia për këtë lidhet me instanca shumë më të larta se njësia kryesore dhe njësia bazë.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon	Koordinatori i programit të studimit, sipas RVB-së dhe gjetjeve gjatë vizitave në institucion është drejtuesi i Departamentit organizues të tij (Aneks 2.9 Koordinatorët e programeve të studimit dhe përgjegjësit e tyre), i cili ka kualifikimet dhe eksperiencën e nevojshme për ecurinë e programit (Evidenca 2.1.7. CV e stafit akademik të departamentit).

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


  
 Faqe 14

vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.									
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësia kryesore dhe ajo bazë e programit të studimit nën vlerësim janë të strukturuar të organizuara sipas detyrimeve ligjore dhe nën ligjore në fuqi ( <i>Nenet 22, 23 dhe 25 të Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"</i> ).								
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Në RVB raportohet gabimisht se "në përbërjen e Departamentit janë aktualisht 6 pedagogë me kohë të plotë" (f. 23), siç u shtjellua në rubrikën mbi Standardin I.4, Kriteri 3 ( <i>krhs. Evidenca pas vizitës Nr. 20, Tabela e përditësuar e përbërjes së stafit akademik</i> ). Megjithatë, ngarkesat e larta të pedagogëve të Departamentit dhe numri i ulët i studentëve ka shkaktuar mungesë të personelit akademik efektiv me orientim kërkimor-shkencor, në frymën e <i>Nenet 59, Pika 2 të Ligjit Nr. 80 për Arsimin e Lartë / 2015</i> , edhe pse personeli akademik i departamentit paraqet gjithashtu dhe veprimtari kërkimor shkencor.  <b>Sugjerim:</b> Të rritet personeli akademik efektiv për të përfshirë edhe personel me karakter kërkimor-shkencor, ose të reduktohen ngarkesat e personelit akademik efektiv ekzistues, në mënyrë që t'i mundësohet rritja e kohës së angazhimit me kërkimin shkencor.								
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Pozicionimi i GVJ-së për <i>Standardin I.4, Kriteri 1</i> , vlen edhe këtu, pra ngarkesat e larta të pedagogëve të Departamentit dhe numri i ulët i studentëve ka shkaktuar mungesë të personelit akademik efektiv me orientim kërkimor-shkencor, në frymën e <i>Nenet 59, Pika 2 të Ligjit Nr. 80 për Arsimin e Lartë / 2015</i> , edhe pse personeli akademik i departamentit paraqet gjithashtu dhe veprimtari kërkimor shkencor. Në një shkallë të vogël, ngarkesat mësimore (ku të gjithë anëtarët e personelit akademik efektiv janë me shumë orë suplementare), si dhe numri apo shpërndarja e lëndëve të ofruara nga pedagogët, nuk i përmbahen <i>Pikës 6 të Kreut II të Udhëzimit Nr. 29 / 10.09.2018, të ndryshuar (me Udhëzimin Nr. 37 / 04.12.2018)</i> . Siç u tha edhe më sipër, GVJ-ja ka konstatuar ndërgjegjësimin e instancave kompetente në këtë sfidë.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							


### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Si Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, ashtu edhe Departamenti i Gjuhës Greke disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit (<i>Evidenca 1.8 Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe 2.1.1. Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Greke</i>). Madje, këto informata u komunikohen palëve të interesit përmes mediave publike (<i>Evidenca 2.11., Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Faqja Zyrtare, <a href="http://www.fgjh.edu.al">www.fgjh.edu.al</a></i>). Takimi me studentët tregoi se edhe studentët, në vija të përgjithshme, kishin dijeni të këtyre informacioneve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p><i>Akens-Tabela Nr. 10</i> tregon se programi i studimit (<i>Tabela 10</i>) është i organizuar në lëndë, module dhe aktivitete formuese në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (<i>VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar</i>). Kjo praktikë zhvillohet brenda kuadrit lëndor dhe nuk parashikohet si aktivitet i mëvetshëm.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programet e studimit organizohen në bazë të kreditit evropian si njësi matëse të ngarkesës akademike mësimore dhe studimore (<i>Aneks Tabela 10, Plani mesimor</i>) sipas sistemit shqiptar dhe evropian.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programet lëndore (silabët) përmbajnë informata të detajuara për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, frekuentimin / ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive etj. (<i>Evidenca 2.1.6. Syllabuset</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Kritere pranimi, transferimi dhe ekuivalentimi të studimeve ka dhe ato u komunikohen palëve të interesuara. Nenet 16-18 të rregullores së programit të studimit (<i>Aneks 2.1.1; krhs. Evidenca 1.8. Rregullorja e Fakultetit, Kreu 3, Neni 78-79</i>) u referohen atyre. Kriteret e pranimit komunikohen edhe në portalin e Ministrisë dhe janë të aksesueshme edhe nga maturantët.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e studimit janë, pjesa më e madhe, të formatuara sipas Aneks Tabeles 14 (<i>krhs. Evidenca 2.1.6. Syllabuset e lendeve te ofruara ne vite</i>), në bazë të <i>Shtojcës nr. 2 të VKM nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar</i>. Por, siç u detajua më sipër (<i>Standardi II.1, Kriteri 5</i>), Departamenti është i ndërgjegjësuar për nevojën e rishikimit të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik</p>	<p>Përmbajtja e programit është objekt përmirësimi dhe përditësimi të vazhdueshëm. Në RVB, GVB-ja u fokusua tek përmirësimet në nivel meso / makroskopik, pra në masën jo më të madhe se 20% (<i>Aneks te vizitës Nr.</i></p>






miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	11, Procedura e ndryshimit të kurrikules, plani i firmosur, Vendimi i Senatit). GVJ-ja do të donte të shikonte gjithëpërfshirje të palëve të interesit në këtë proces (evidencat e dorëzuara janë nga niveli i drejtusit të departamentit e gjër në Senat) dhe e ka vertëtuar atë përmes intervistave me studentë dhe pedagogë gjatë vizitave në Institucion.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e punës së programit të studimit është strukturuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar), si edhe parashikimet e Rregulloreve të Departamentit dhe Fakultetit, siç reflektohen në rregulloren e programit të studimit (Evidenca 2.1.1.). Aneks-Tabela Kurrikula Nr. 10 tregon shpërndarjen e plan programit në 3 vite akademike me nga 60 ECTS për secilin vit. Këto kredite (ECTS) shpërndahen në dy semestra me nga 15 javë, sipas Rregullores së Universitetit të Tiranës (Aneks 1.7, Neni 33) dhe jo me 13 javë, siç deklarohet në kriterin përkatës të RVB-së. Vlen të vërehet se, planet lëndore ndjekin strukturën e nënkuptuar nga rregullorja e universitetit (15 javë dhe 15 tema), ku temat reduktohen nën 10% pa arsytim (Aneks 2.1.6 Syllabuset, Viti i trete 2021-2022, ff. 6-10 dhe 66-71).
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve, duke ofruar lëndë hyrëse, lëndë të gjuhës greke, të gjuhësisë, letërsisë dhe kulturës greke (Aneks Tabelat 9-10). Mungesa e praktikës është prekur më lartë.
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Shpërndarja e lëndëve në vite dhe semestra është racionale dhe mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. (Shtojca 2.1.8, Planet Mësimore, f. 2). <b>Sugjerim:</b> GVJ-ja sugjeron të rishikohet arsyetimi i vendosjes së një lëndë hyrëse ('Hyrje në Komunikim' ose 'Psikologji') në vitin e tretë, pasi niveli i lëndëve mund të jetë më i përshatshëm për studentë në vitin e parë.
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori	GVJ-ja konkludoi se si struktura e programit, ashtu edhe lëndët dhe emërtimet e tyre janë në përputhje me profilin e programit të studimit, por sugjeron që të shihet mundësia e përcaktimit, në kurrikula, të njohjeve

<p>praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>paraprake në strukturën e lëndëve; p.sh., nuk është e qartë nëqoftëse, studenti që rezulton jokalues në një lëndë me referencë të drejtpërdrejtë në një lëndë tjetër (si Përkthim I dhe Përkthim II) i lejohet të ndjekë lëndën më të avancuar pa kaluar lëndën e mëparshme të fushës. Prandaj, janë deri diku të përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare (<i>krhs. me programin e ngjashëm të Institutit të Arsimit në Profesion dhe Trajnimit të Republikës Sllovene</i>, <a href="https://europa.eu/europass/sr/courses/qualification/b741a151-2c88-41c6-b068-5cf24918ff14">https://europa.eu/europass/sr/courses/qualification/b741a151-2c88-41c6-b068-5cf24918ff14</a>), vetëm se objektiva mësimore e atij programi studimi kërkon një element praktik që mungon në programin e studimit nën vlerësim.</p> <p>Të pyetur se si arrijnë t'u përcjellin studentëve kompetenca në përdorimin e gjuhës greke, personeli akademik deklaroi se këto elemente jepen përmes praktikave. Ballafaqimi i këtyre pohimeve me planet mësimore lëndore i konfirmon pjesërisht. Lënda 'Përkthim I,' p.sh., ka element detyre kursi në përshtetimin e vlerësimit dhe detyra praktike mund të përfytyrohet si aktivitet me vlerësim përmbledhës, por vazhdimi i lëndës (Përkthim II) nuk ka parashikim për detyrë kursi; rrjedhimisht, ushtrime përkthimore me vlerësim formues dhe jo përmbledhës që tërheqin më pak vëmendjen e plotë të studentëve (<i>Aneks 2.1.6 Syllabuset, 2021-2022, Viti i tretë, ff. 7-12 dhe 42-48</i>).</p> <p><b>Sugjerim:</b> Të shihet mundësia e përcaktimit në kurrikula, të njohjeve kushteve paraprake në strukturën e lëndëve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur evidenca bindëse në lidhje me mobilitetet e studentëve (<i>Aneks gjatë vizitës, Mobiliteti Studenti me ERASMUS+</i>). Ky është tregues se ndarja sipas veprimtarive formuese, si edhe raporti teori-praktikë mundëson përgatitjen e studentëve në mënyrë që të lehtësohet edhe mobiliteti i tyre.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Ndërsa nevoja për rishikimin e kurrikulave është prekur më sipër, kërkesa për literaturë të pesë viteve të fundit nuk është gjithmonë realiste për këtë program studimi. GVJ-ja konstatoi se lëndë përdorin një literaturë klasike të viteve më të hershme se 5 viteve të fundit (p.sh. gramatika referuese, fjalorë klasikë), por kjo është e pritur dhe normale për fushën e programit. Suplementimi i kësaj literature me burime elektronike (<i>Aneks Tabela 17</i>) moderon efektin e përdorimit të një literature më të vjetër.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ-ja është përgjithësisht dakord me pohimin e GVB-së në RVB. Nga ana tjetër, evidenton se duhen riparë planet mësimore të lëndëve Anglishtja I dhe II, viti III, në mënyrë që të shmangen duplikimet e dijeve (<i>Aneks 2.1.6 Syllabuset, 2021-2022, Viti i trete 2021-2022, 26-31 dhe 85-90</i>).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në</p>	<p>Gjithashtu, GVJ-ja sugjeron të rishikohet edhe ngarkesa javore lëndore që i kërkohet studentëve, pasi nga njëra anë vihet re se në disa plane mësimore ngarkesa javore studimore për studentët është 7-14 faqe në disa lëndë, por jo në lëndë të tjera. GVJ-ja është i mendimit se kjo ngarkesë studimore javore për literaturë të detyrueshme paraqitet pakaz i pamjaftueshme nuk</p>



<p>përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>justifikon ngarkesën lëndore studimore të pavarur apo gjysëm të pavarur me 4 ECTS, siç përshkruhet në RVB-në, Standardi II.1, Kriteri 5. P.sh. lënda Didaktikë e Gjuhës së Huaj I i ofrohet studentëve të v. III, pra për studentët që tashmë kanë kryer tranzicionin nga shkolla e mesme. Lënda mbart një ngarkesë prej 4 ECTS me 40 orë në auditor dhe 60 orë për studim të pavarur, sipas formules së cituar në RVB-në. Sasia e faqeve për studim e përcaktuar në bazë të përjavshme është gjithsej 127 faqe studimi për gjithë 15 javat e semestrit, sasi mjaft e moderuar për një lëndë të v. III, sipas GVJ-së (<i>Aneksi 2.1.6 Syllabusët, Viti i trete 2021-2022, ff. 13-17</i>).</p> <p><b>Sugjerim:</b> Ngarkesa mësimore studimore javore të rishikohet gjatë rishikimit të silabëve.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Mungesa e praktikave që do të lehtësonte marrëdhëniet e vazhdueshme me tregun e punës, është evidentuar edhe më sipër (<i>Standardi I.1.4, Standardi I.3.2, Standardi I.5.4 dhe Standardi I.5.5</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Siç është analizuar më sipër (<i>Standardi I.4</i>), personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i programit të studimit, i cili shërben për objektivat e programit, plotëson përgjithësisht kërkesat ligjore në fuqi, siç mund të shihet nga <i>Tabelat e përditësuara 1 &amp; 6 (Tabela 1 &amp; 6)</i>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Pavarisht ngarkesave mësimore të tyre, personeli akademik raporton një prodhimtari mjaft të kënaqshme kërkimore – shkencore (<i>Aneks CV të stafit, dorëzuar gjatë vizitës</i>). Megjithatë, kërkohet një përpjekje sistematike për botime artikujsh në revista të indeksuara dhe të rankuara në Clarivate Analytics (ish-Thomson/Reuters), ose SCOPUS, ose librash/kapituj në shtëpi botuese të rankuara në SENSE Academic Publishers.</p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Ngarkesat e mëdhaja mësimore (<i>Aneks Tabelat, Tabelë Nr. 4</i>) detyrojnë pedagogët me kohë të plotë të shtrihen në shumë fusha të mësimdhënies, saqë të jetë e pamundur të paraqesin veprimtari kërkimore në të gjitha prej tyre, mungesa e pedagogëve me grada dhe tituj nga personeli akademik me kontratë (sigurisht e kushtëzuar edhe nga kufizimit e ofertës në personel akademik) dhe mungesa e personelit me orientim kërkimor, vlejné edhe këtu.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për sa i përket Kriterit Nr. 4, institucioni nuk raporton praktika në nivel Bachelor.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në lidhje me Kriterin Nr. 5, institucioni nuk raporton angazhimin e personelit ndihmës mësimor për orë laboratorike, për arsyen se “nuk ka pasur nevojë për mbështetje nga stafi laboratorik mbështetës, pasi natyra e programit nuk e kërkon atë (<i>Evidenca Plani mësimor</i>).”</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>


<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p><b>Standardi III.1</b> Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Institucioni raporton një udhëzues të tillë, aty IAL-ja e kishte më tepër nevojë, në kohën e pandemisë dhe mësimdhënies online si masë parandaluese të përhapjes së COVID-19 (<i>Referenca: Evidenca Nr. 3.2 Rregullorja e Brendshme e UT "Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi Covid-19", e ndryshuar; por kryesisht Evidenca Nr. 3.1, "Rregullorja e posacme e UT mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online në Universitetin e Tiranës për sezonin e dimrit të vitit akademik 2020-2021 dhe Udhëzimin për provimet dhe mënyrat e tjera të shlyerjes së detyrimeve akademike"</i>). Vihet re se rregullorja në fjalë nuk është udhëzues i mirëfilltë për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, ndërsa stafi akademik, i pyetur nëqoftëse ka udhëzues të tillë, përgjigjen se "është bërë një skedim në Athinë që ne orientohemi; kemi ndjekur disa materiale nga Selaniku" (<i>Aneks "Minutat Gjuha Greke," f. 7).</i></p> <p><b>Sugjerim:</b> GVJ-ja mendon se duhet një sistemim i këtyre materialeve për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në trajtë udhëzuesi, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Institucioni ka zhvilluar mekanizma monitorimi dhe vlerësimi periodik të performancës së mësimdhënies të personelit akademik. Parashikimet edhe janë statutore dhe rregullative (<i>Aneks Nr. 3.3 – Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2018-2023; Nr. 1.2 – Strategjia e UT 2018-2023; Nr. 1.5 – Strategjia e FGJH; Nr. 1.7 Rregullore e UT</i>) edhe realizohen përmes veprimtarisë vlerësuese të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ndërsa edhe vetë reflektimi nëpërmjet procesit të akreditimit mund të cilësohet edhe si mekanizëm i tillë monitorimi (<i>Aneks nr. 1.9 – Rregullore e NJSBC; Nr. 3.4 – Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë. Nr. 3.5 – Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL; Nr. 3.6 – Manual i sigurimit të cilësisë; Nr. 3.7 – Paketa e Instrumentave të cilësisë; Nr. 3.8 – VKM Nr. 531 datë 11/09/2018 Kodi i Cilësisë; Nr. 3.9 – Përcillet vendimi i Rektoratit Nr. 08, datë 29.03.2022; Nr. 3.10 - Rregullore për funksionimin e njësisë të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja; Nr. 3.11 Urdhër/vendim për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së në nivel njësie kryesore; Nr. 3.12 Urdheri i dekanit për ngritjen e GVB-se</i>). Institucioni nuk raporton monitorim të mësimdhënies nga të barabartit (peer-to-peer assessment) dhe rrjedhimisht vlerësimet vjetore realizohen vetëm përmes vlerësimit të shërbimeve të pedagogëve nga studentët (<i>Aneks Nr. 3.13 "Formular vlerësimi nga personeli akademik dhe formular vlerësimi nga studentet i mesimdhënies në distancë;" Nr. 3.13.1. "Raporti përmbledhës mbi pyetesorin e mesimdhënies në distancë-Komentet perkatese"</i>), por edhe nga të diplomuarit (<i>Aneks 3.13.2. "Vlerësimi i studenteve që janë diplomuar"</i>). Nga ana tjetër, leksionet e hapura nga pedagogë të afirmuar në vende të Bashkimit Europian, sipas pohimeve të personelit akademik dhe kryesisë së njësisë kryesore dhe asaj bazë, shërbëjnë si modele të mira për mësimdhënien dhe të nxënit.</p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Studentët përfshihen në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve, siç ka paraqitur RVB-ja bindshëm (<i>Evidenca Nr. 3.13, Formular vlerësimi për personelin akademik dhe formular vlerësimi nga studentët për mësimdhënien në distancë; Nr. 3.13.1, Raporti përmbledhës mbi pyetëtorin e mësimdhënies në distancë; Nr. 3.13.2, Vlerësimi i studentëve që janë diplomuar MODEL -Pyetëtori "Vlerësimi i lendes dhe i pedagogut nga studenti"</i>).</p> <p>Duke mos gjetur asnjë referencë ose evidencë në RVB-në në lidhje me përfshirjen e studentëve në trajtimin e ankimimeve, GVJ-ja i përkushtoi kësaj opike vëmendje të veçante gjatë vizitës në institucion. Studentët gëzojnë të drejtën të përfshihen edhe në trajtimin e ankesave të tyre, siç rezultoi nga takimet me studentët dhe personelin akademik, mirëpo nuk ka pasur ankesa, ndërsa studentët deklaruan se kërkesat e tyre merren parasysh (<i>Aneks "Minuta Gjuha Greke," f. 12</i>). Megjithatë, nga pjesëmarrja e ulët e studentëve në takimin me GVJ-në tregohet një nivel jo aq i lartë ndërgjegjësimi, sa do të duhej për vlerën e aktiviteteve monitoruese dhe vlerësuese të cilësisë në programin e studimit nën vlerësim.</p> <p><b>Sugjerime:</b> 1. Të reflektohet në instancat kompetente mundësia e zgjerimit të instrumenteve të vlerësimit të mësimdhënies dhe të nxënit, duke përfshirë edhe monitorim të mësimdhënies nga të barabartit (peer-to-peer assessment). 2. Të punohet më sistematikisht me studentët për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre aktive nëpër aktivitete monitoruese dhe vlerësuese të cilësisë në programin e studimit nën vlerësim.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NjSBC-ja informon në mënyrë periodike përgjegjësin e departamentit dhe dekanin rreth rezultateve të aktiviteteve monitoruese dhe sigurisë së cilësisë në mësimdhënie. Të dhënat përkatëse, të moderuara, publikohen edhe në raportin vjetor të institucionit (<i>Aneks 3.14.1 "Raporti vjetor 2018-2019" dhe 3.14 "Raporti i veprimtarisë mesimore kerkimore - shkencore per vitin 2020-2021"</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni raportoi se, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. Përveç anekseve të cituara në RVB, GVJ-së i duket bindëse edhe pjesëmarrja e dy anëtarëve të departamentit në trajnimin e kryer prej mentorëve të DAAD në kuadrin e projektit "Bologna Peer Hub Support" (<i>Aneks "Minutat Gjuha Greke," f. 15</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

**Standardi III.2**

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Leksionet, seminarët, detyrat e kursit / esetë, dhe orët e hapura përbëjnë forma të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në këtë program studimi, siç dëshmohet prej shqyrtimit të planeve mësimore (<i>Evidenca 2.1.8 "Planet mesimore 2018- 2019, 2019-2020-2020-2021;" Evidenca 2.1.6 "Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite;" Evidenca 2.1.1 "Rregullore e Programit të Studimit;" Aneks RVB: Tabela 13, "Format e mësimdhënies"</i>). Siç është përmendur edhe më sipër, ky program nuk ka praktika profesionale të strukturuar në mënyrë të mëvetshme.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Si pohimet e GVB-së në RVB-në, ashtu edhe deklaratat e personelit akademik tregojnë se mungesa e studenteve me aftësi dhe stile të të nxënit të ndryshme nuk ka nxitur sistematikisht forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, por studentet deklaruan se pedagogët e tyre ishin të hapur për sqarime dhe shpjegime. Miratimi i dokumentit-politikë të titulluar <i>Strategjia e gjithëpërfshirjes së studenëve me aftësi ndryshe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja</i>, sipas GVJ-së, është një hap shumë i rëndësishëm në këtë drejtim (<i>Evidenca e dorëzuar GVJ-së gjatë vizitës</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Pedagogët e Departamentit të Gjuhës Greke kanë marrë pjesë në trajnime me synim përmirësimin e kompetencave didaktike, siç është përmendur më sipër. Kompletimi i një laboratorit të ri të dedikuar përkthimit, siç u evidentua gjatë vizitës, u jep mundësi pedagogëve të pasurojnë edhe më tej larinë e metodave të tyre mësimore (<i>krhs. Aneks "Evidenca e Ndërtësës mbi Mjediset e Fakultetit," Tabela 16</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Studimet dhe veprimtaria mësimore dhe kërkimore-shkencore e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit nën vlerësim është e përshatshme për t'i aftësuar në shpjegimin e njohurive e koncepteve (<i>Aneks RVB: Tabela 1, 2, 6, 7, 12; Evidenca nr. 2.1.7 - CV-të e stafit akademik</i>). Përdorimi i metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, vlerësohet nga studentët, siç është analizuar më sipër. Personeli akademik gjatë vizitës deklaroi përmirësim në format e metodat e mësimdhënies, fal edhe përfshirjes të studentëve. Edhe pse deklaratat nuk u mbështet me evidencë, ballafaqimi i tyre me përgjigjet e studentëve kanë bindur GVJ-në se ka pasur përmirësim, por është e pa mundur të përcaktohet shkalla.</p> <p>Shqyrtimi i silabëve të programit të studimit dhe sidomos elementi i detyrave të kursit që zhvillohet me udhëzime të caktuara, por në mënyrë të pavarur</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	



<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	nga studentët, e ka bindur GVJ-në se aktivitetet mësimore nxisin sensin e autonomisë dhe përgjegjësisë së studentëve ( <i>Evidenca 2.1.8 Planet mesimore 2018- 2019, 2019-2020-2020-2021; Evidenca 2.1.6 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</i> ).			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Si evidencat e cituara ( <i>Aneksi, Tabela Nr. 16</i> ), ashtu edhe vizita në institucion ka bindur GVJ-në se hapësirat në të cilat realizohet programi i studimit nën vlerësim janë të mjaftueshme dhe cilësore, sidomos laboratorit i ri për përkthimin.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Nga vizita në Institucion, GVJ konfirmon se ambientet e dedikuara për procesin mësimor të këtij programi studimi janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e duhur.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Si personeli akademik, ashtu edhe studentët kishin akses në pajisje dhe sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshëm për realizimin e procesit mësimor ( <i>Aneksi Tabelat, Nr. 16-17</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe e rekomanduar që u vihet fizikisht dhe elektronikisht në dispozicion studentëve në gjuhën greke ( <i>Aneksi Nr. 2.1.6 Syllabuset</i> ), përgjithësisht garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Literatura e detyrueshme ishte e disponueshme fizikisht, pothuajse ekskluzivisht në bibliotekën e departamentit, ndërsa studentët raportuan se pedagogët shfaqnin gjithashtu, edhe elektronikisht materialet mësimore në dispozicion ( <i>krhs. Aneks Tabela Nr. 17</i> ).




<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e Fakultetit (kjo bibliotekë është e ndryshme nga biblioteka brenda ambienteve të zyrës së Departamentit) u konstatua një numër librash ndihmës në gjuhën greke. Për mendimin e GVJ-së numri i tyre ishte më i ulët se ç’ pritej dhe prania e shumë kopjeve prej të të njëjtit titull e intensifikoi këtë përshtypje, aq më tepër që pjesa më e madhe e librave rezultoni të pa-hapur.</p> <p>Edhe pse në fushën e filologjisë greke nuk është gjithmonë e mundur që literatura mësimore të jetë botuar brenda 5 viteve të fundit, për arsye të specifikave të fushës (ndryshe nga disa fusha të tjera), kjo literaturë nuk është e domosdoshme. GVJ-ja kërkoi një evidencë shtesë për libra të porositur prej bibliotekës së institucionit gjatë tre viteve të fundit. Evidenca e paraqitur (<i>Aneks gjatë vizitës “Tituj të shtuar librash”</i>) nuk mbartin datë, por titujt janë qartazi për këtë program studimi. GVJ-ja është i mendimit se bibliotekës së programit të studimit i duhet një pasurim më serioz me materiale në letër dhe dixhitale, për të lehtësuar nëvojat e kërkimit shkencor, si edhe një plan veprimi se si këto do t’i vihen në shërbim studentëve të programit të studimit.</p> <p><b>Sugjerim1:</b> Të hartohet dhe miratohet një plan disa-vjeçar zhvillimi dhe pasurimi i bibliotekës dhe të akordohen fonde konkrete për implementimin e saj.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Institucioni raportoi të përdoren edhe biblioteka dixhitale (<i>Aneks Tabela Nr. 17</i>), mirëpo kërkesa e GVJ-së për ta evidentuar këtë gjë gjatë vizitës në bibliotekën e Fakultetit nuk u realizua. Megjithatë, në diskutimet me personelin akademik GVJ-ja dëgjoi se pedagogët kanë përdorur databazat dixhitale si JSTOR (<i>Aneks “Minuta Gjuha Greke,” f. 7</i>), mirëpo institucioni nuk ishte në gjendje të paraqiste të dhëna të përdorimit, ndërsa edhe studentët e kishin dëgjuar, por kurrë nuk e kishin përdorur këtë database (<i>Aneks “Minuta Gjuha Greke,” f. 7</i>).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Programi i studimit nën vlerësim nuk kërkon infrastrukturë laboratorike si parakusht për realizimin e tij, edhe pse me dixhitalizimin e filologjisë bëhet edhe më i domosdoshëm. Gjatë vizitës në IAL, vërem se laborator i ri i përkthimit është një hap i mirë në këtë drejtim. Edhe pse në bibliotekë ka patur stacione kopmjuterike në shërbim të studentëve, vetë studentët kanë deklaruar se përdoren.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Departamenti dhe studentët pohuan se gjatë pandemisë përdorën platformën TEAMS (<i>Aneks 3.16.1-5 mbi këtë platformë</i>). Pas pandemisë platforma nuk përdoret më, mirëpo, disa elemente të saj, si ngarkesa e materialeve mësimore nëpër depozitorë dixhitalë ende vazhdojnë të praktikohen.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>GVJ-ja zbuloi se sistemet bazë të komunikimit të brendshëm përdorëshin edhe për akses në dokumentacionin elektornik (<i>Aneks 3.16.1-5 mbi këtë platformë</i>), por hapësira vetjake e dedikuar e TEAMS nuk vazhdoi që pas pandemisë.</p>




<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Përzgjedhja e temave, sipas Departamentit, bëhet nga studentët në bazë të kërkesave të tyre dhe temave të propozuara nga stafi akademik. Gjatë intervistave me pedagogët dhe pas verifikimit të informatave prej tyre me studentet, GVJ-ja kuptoi se Departamenti lëshon një listë temash sipas ekspertizës së stafit akademik dhe studentët përzgjedhin temën që i afrohet më shumë interesave të tyre ( <i>Evidenca Nr. 1.7.- Rregullore e Përgjithshme e UT-së; Nr. 2.1.1 - Rregullore e Programit të studimit ku do të përshkruhet procedura e përzgjedhjes së temës dhe orientimi dhe asistenca e pedagogut udhëheqës</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) për të monitoruar dhe promovuar përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel Fakulteti, në zbatim të kuadrit normativ; NjSBC-ja është e pajisur me instrumente të përshtatshëm për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies ( <i>Evidenca Nr. 1.1 – Statuti i UT-së; Nr. 1.9 – Rregullore e NJSBC; Nr. 3.4 – Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë; Nr. 3.5 – Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL; Nr. 3.6 – Manual i sigurimit të cilësisë; Nr. 3.7 – Paketa e Instrumentave të cilësisë; Nr. 3.8 – VKM Nr. 531 datë 11/09/2018 Kodi i Cilësisë; Nr. 3.9 – Përcillet vendimi i Rektoratit Nr. 08, datë 29.03.2022</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Përpos rolit të qendrueshëm të NjSBC-së, edhe GVB-ja është një strukturë <i>ad-hoc</i> që përmes vlerësimit, promovon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në çdo veprimtari. Rrjedhimisht, edhe në mësimdhënie, siç pohuan edhe anëtarët në takimin me GVJ-në ( <i>Aneks “Gjuhë Greke,” f. 4</i> ).




<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Sipas RVB-së, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe Departamenti përkatës i programit të studimit nën vlerësim, “mbështesin metodat e reja inovative të mësimdhënies.” Edhe pse citimi i dokumenteve strategjike dhe manualeve (<i>Aneks Nr. 3.17 - Strategjia për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit; Nr. 3.16 e-Student Pedagog; Nr. 3.16.1 Manual sistemi e-Student; Nr. 3.16.2 Manual perdorimi Microsoft Teams; Nr. 3.16.3 Microsoft office 365 për student; Nr. 3.16.4 Microsoft office 365 Teams; Nr. 3.16.5 Udhezues bazik_Microsoft Teams (1)</i>) nuk japin detaje të mjaftueshme, as për llojet e eksperimentimit dhe zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies, as për vlerësimin e eksperimenteve dhe sesi shpërndahen praktikat më të mira. Argumentimi i RVB-së se e gjithë përvoja e pandemisë ka qenë në vetvete një eksperimentim madhor në metoda të reja të mësimdhënies, cilësohet bindës për GVJ-në. Përvoja e përfituar është e përfshirë në raportimet periodike të njësisë kryesore (<i>Aneks Nr. 3.14.1, “Raporti vjetor 19-20;” Nr. 3.14.2, “Raporti vjetor per veprimtarite e kryera 2020-2021 FGJH;” Nr. 3.14.3, “Raporti vjetor 2018-2019 Sllave dhe Ballkanike; Nr. 3.14.4, “Raporti vjetor 2018-2019 greqisht;” Nr. 3.14.5, “Aktivitete-Konferenca-antologjia-workshop - shperndarje bursash te departamentit greqisht; Aneks RVB, Tabelat 18-20).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Sipas RVB-së, institucioni “mbështet stafin akademik efektiv për avancimin në kualifikimin e tyre si dhe në pjesëmarrjen në aktivitete brenda dhe jashtë vendit;” madje “së fundmi kjo shoqërohet edhe me mbështetje financiare” (<i>Aneks Nr. 3.21 - “Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës”, miratuar me vendim Senati Akademik Nr. 11, datë 26.04.2018; Nr. 3.21-Vendimi i Senatit Akademik Nr. 28, dt.22/07/2021; Nr. 3.21- Vendimi i Senatit Akademik Nr. 29, dt.22/07/2021; Nr. 3.22 – Rregullore “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratës në UT, miratuar me Vendimin nr. 8, dt.26/04/2021 të Senatit Akademik të UT-së; Nr. 3.22 - Rregullore për ushtrimin e veprimtarisë së KPPA-së).</i></p> <p>Megjithatë, GVJ-ja evidenton mungesë të botimeve në revista të indeksuara, gjë që e përmendëm edhe në Standardin II.5 dhe përserit rekomandimin e dhënë po aty.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Siç u prek edhe më lartë, Dekanati shfrytëzon vlerësimet si nga NjSBC-ja, ashtu edhe nga GVB-ja për të organizuar trajnime (<i>shih Standardi III.1</i>) që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, ndërsa mësimet të hapura me lektorë të huaj të ftuar ofrojnë mundësi për të parë modele të tjera, duke kompensuar, deri në një fare pike, mungesën e vlerësimit të mësimdhënies dhe të nxëniet nga të barabartit, me synim gjenerimin e një dialogu për pedagogjinë universitare.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Kuadri rregullativ i cituar në RVB (<i>Aneks Nr. 1.1 Statuti i UT-së; Nr. 1.7 – Rregullorja e përgjithshme e UT-së (nenet 27-29); Nr. 2.1.1 - Rregullorja e Programit të Studimit</i>) dhe intervistat me instancat drejtuese, personelin akademik dhe studentet (<i>Aneks gjatë vizitës “Minutat Gjuha Greke,” ff. 1-13</i>) i kanë krijuar GVJ-së përshtypjen se personeli akademik dhe ndihmës akademik merr përgjegjësi për realizimin sa më të suksesshëm të programit të studimit, duke investuar edhe kohë personale për përkujdesjen baritore të studentëve, me synim rritjen intelektuale, personale, ndërpersonale dhe profesionale të studentëve të tyre.</p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Personeli akademik ka deklaruar me shembuj se eksperimentojnë me metoda të reja të mësimdhënies, të nxëniet dhe të mësuarit me projekte reale nga Departamenti. Sigurisht, edhe nevojat e pandemisë kanë kushtëzuar përfshirjen e teknologjisë në mësimdhënie, edhe pse jo me kushte optimale. Nga ana tjetër, GVJ-ja evidenton se raste të tilla raportohen (<i>Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë; Evidenca 3.14.1 Raporti vjetor 19-20; Evidenca 3.14.2 Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera 2020-2021 FGJH; Evidenca 3.14.3 Raporti vjetor 2018-2019 Sllave dhe Ballkanike; Evidenca 3.14.4 Raporti vjetor 2018-2019 greqisht</i>), por jo në mënyrë sistematike, nuk kapitalizohen praktika më të mira për dobi të të gjithëve, ndoshta për shkakun se ngarkesa e madhe e personelit akademik nuk i lejon kohë të dedikuar për të reflektuar më shumë mbi çështje të tilla.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>E bazuar në Rregullorën e përgjithshme të Universitetit të Tiranës (<i>Aneks Nr. 1.7 - Rregullore e Përgjithshme e UT-së</i>), Rregullorja e programit të studimit nën vlerësim (<i>Aneks Nr. 2.1.1 - "Rregullore e Programit të studimit"</i>) parashikohet një mënyrë transparente e kriterëve dhe mënyrave të larmishme të vlerësimit të njohurive të dijeve dhe aftësive profesionale. Tabela përmbledhëse (<i>Aneks RVB: Tabela 15</i>) që premtonte të moderonte të dhënat analitike që paraqiten në planet lëndore nuk u plotësua, megjithatë vështrimi krahasues i silabëve (<i>Aneks 2.1.6 Syllabuset</i>) tregon standardizimin me komponentë të vlerësimit të vazhdueshëm (provim gjysëm semestral, aktivizim i vazhdueshëm) dhe të vlerësimit të aftësive praktike (detyra e kursit), edhe pse jo domosdoshmërisht të vlerësimit të aftësive profesionale, përpos mënyrave të mirëfillta përmbledhëse (provim përfundimtar), të cilat cilësohen si të mjaftueshme sipas GVJ-së, aq më tepër kur kombinohen edhe me informata të përmbledhura që studenti mund të marrë në dokumente të tilla si <i>Guida / Udhërrëfyesi i Studimeve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (Aneks Nr. 3.19)</i> dhe <i>Programi i Transparencës në universitet (Aneks 3.20)</i>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Metodat e vlerësimit bëhen transparente duke u detajuar në planet lëndore të programit të studimit (<i>Aneks 2.1.6 Syllabuset</i>). Megjithatë, GVJ-ja sugjeron, nëqoftëse asambleja e personelit akademik të departamentit e gjykon të arsyeshme, që kriteret e vlerësimit të detajohen dhe jo thjeht të përmenden, duke u dhënë disa udhëzime studentëve për sa i përket detyrave të kursit, ose për mënyrën se si ata mund të arrijnë rezultate të shkëlqyeshme. Për të ilustruar këtë sugjerim, përshkrimi i kontrollit të dijeve të ilustruar këtu:</p>



<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<b>KONTROLL I VAZHUESHËM:</b> <i>Vlerësimi i studentit mund të përfshijë, por nuk kufizohet në të mëposhtmet:</i>			
	Kontroll i ndërmjetëm me shkrim		30%	
Provimi përfundimtar i lëndës		60%		
Aktivizimi në diskutime / seminare, teste të rastesishme, detyrë kursi		10%		
<p>(Aneks Nr. 2.1.6 Syllabuset\2021-2022\Viti i pare 2021-2022, f. 27). Ky regjim vlerësimi paraqitet pak evaziv, duke qenë se pohimi se “vlerësimi i studentit mund të përfshijë, por nuk kufizohet në...” lë hapësirë për ndryshime gjatë procesit të mësimit, ndërsa pesha e vogël 10% për “aktivizim në diskutime / seminare,” edhe “teste të rastesishme,” edhe “detyrë kursi,” i duket GVJ-së si vlerësim i tepërt (overassessment). Mandej, GVJ-ja do të donte të paraqiteshin disa detaje për llojin e testeve të rastësishme dhe detyrën e kursit, por instrumente të tilla vlerësimi nuk arkivoheshin nga Departamenti.</p> <p><b>Sugjerim:</b> Në kuadrin e rishikimit të planeve lëndore të fiksohet dhe detajohet regjimi i vlerësimit edhe me udhëzime konkrete.</p>				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.6</b> <b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Shqyrtimi i planeve lëndore (Aneks 2.1.6 Syllabuset) shfaq disa elementë të vlerësimit të vazhdueshëm; vlerësimi që realizohet përgjatë semestrit, i njohurive dhe dijeve (provim gjysëm semestral, aktivizim i vazhdueshëm), dhe të vlerësuarit të aftësive praktike, që realizohen më shumë me detyrat e kursit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Të pyetur nëqoftëse kontrollohen detyrat e kursit për të eliminuar dyshimet për plagjaturë, pedagogët deklaruan se kryejnë vetë kontrole të tilla duke kërkuar në internet ( <i>kërkime me instrumente lundrimi në internet si Google; krhs. Aneks gjatë vizitës “Minuta Gjuha Greke,” f. 7).</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Sipas RVB-së, “Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë të lëndës, nga të cilët njëri duhet të jetë i brendshëm,” i cili “përcaktohet nga titullari i lëndës i cili përgjigjet dhe ndjek zhvillimin e provimit,” duke cituar edhe bazën rregullative ku kjo praktikë mbështetet (Aneks Nr. 1.7 - “Rregullore e Përgjithshme e UT-së,” Neni 27 dhe 48; Nr. 2.1.1 “Rregullore e programit të studimit; Nr. 1.8. “Rregullore e Fakultetit FGJH (2003); Nr. 1.8 “Rregullore e FGJH. 2010”). Këtë praktikë e gjeti të dokumentuar GVJ-ja në shqyrtimin e testimit të vënë në dispozicion (Aneks gjatë vizitës “Tezë provimi”), ku në f. 1 ka shënja të kontrollimit
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 29

<p>sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>nga dy pedagogë (siç tregohet nga shënja korigjimi me dy ngjyra). Provimi ka të dallueshme shënjat e sekretimit (f. 2).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Për të formuar një ide për testimin dhe vlerësimin e njohurive dhe dijeve të studentëve, GVJ-ja gjatë vizitës kërkoi një shembull testimi përfundimtar (<i>Aneks gjatë vizitës "Tezë provimi"</i>). Testimi përmbante ushtrime të larmishme që lejonin vlerësimin e njohurive, dijeve dhe disa aftësive praktike që vihen në objektiva mësimore. Vlerësimi nuk shoqërohej me komente përkatëse, duke qenë se vlerësimi ishte përfundimtar. Gjatë intervistave, pedagogët deklaruan se në aktivitetet e vlerësimit të vazhdueshëm japin komente, mirëpo nuk u paraqit ndonjë shembull i tillë (<i>Aneks 2.1.6, "Syllabuset\2021-2022\Viti i dYTE 2021-2022," ff. 9-15</i>).</p> <p>GVJ-ja sugjeron që testimet të lidhen më ngushtë me kriteret e vlerësimit që përshkruhen në silabët. Vlerësimi përfundimtar i lëndës së sipërpërmendur (<i>Aneks gjatë vizitës "Tezë provimi"</i>) karahasuar me mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm në silab (shihni Standardin III.5.3) paraqet disa ndryshime (që justifikohen me deklaratën "vlerësimi i studentit mund të përfshijë, por nuk kufizohet në..." në silab);</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>•Provimi përfundimtar sipas silabit përbën 60% të notës së lëndës, ndërsa pikët e provimit përfundimtar ishin 75. Nuk është e qarte se si konvertoheshin në përqindje.</p> <p>•Detyra e kursit (me 20 pikë) përmendet në silab së toku me kriteret e tjera që gjithsej zënë 10%. Është e paqartë se si konvertohen pikët në përqindje.</p> <p>•Gjithë pikët, tok me detyrën e kursit, ishin 95 dhe jo 100.</p> <p>•Nuk përmenden në tabelën e testimit përfundimtar kriteret e tjera dhe vlerësimi i tyre, si aktivizimi në diskutime dhe seminare.</p> <p>•Në shkallën e vlerësimit, të dhënë sipas RVB-së, Standardi III.6, Kriteri 5, nota 9 akordohet kur student ka fituar "Nga 85-94 pikë." Është e paqartë përse studenti testimi i të cilit u paraqit dhe u shqyrtua merr 9 me 80 pikë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Edhe pse, në bazë të përgjigjeve të studentit, nota 9/10 paraqitet midis kurajueses dhe të mjaftueshmes, sipas GVJ-së, sugjerohet një konvergjim më i ngushtë midis planeve lëndore, testimave dhe vlerësimeve të lëndëve.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Departamenti i njofton studentët për vlerësimin e tyre me një larmi mjetesh komunikimi, duke i dhënë studentit mundësinë e sqarimit. Koha e ankimimit për rezultatin e vlerësimit (24 orë, sipas RVB-së, Standardi III.6, Kriteri 8, më poshtë, po aty, 48 orë) paraqitet e pamjaftueshme për GVJ-në dhe sugjerohet të rishikohet, por duhet shënuar se as stafi pedagogjik as studentët nuk kanë pasur raste ankimimi, pasi edhe studentët që kishin pikëpyetje, u sqaruan gjatë seancave sqaruese. Ankimimet rregullohen dhe procedura e tyre rregullore nga Nenet 50 dhe 51 të Rregullores së Përgjithshme të UT-së (<i>Aneks 1.7</i>).</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	

	<p><b>Sugjerime:</b> Pas trajnimit që mund të jetë i nevojshëm, personeli akademik sugjerohet të konvergjojë ngushtë objektivat dhe kompetencat që parashikohen në planet lëndore me testimet dhe vlerësimin e lëndës dhe të dokumentojë arsyetimin e përzgjedhjeve të testimeve në bazë të këtyre objektivave dhe kompetencave.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Sipas RVB-së, “ky program studimi synon që studenti të marrë njohuri të thelluara dhe aftësim profesional”, duke cituar Rregulloren e programit (2.1.1- Rregullore e programit të studimit, neni 3, Misioni dhe Objektivat Formuese të Programit). Siç është evidentuar më sipër, programi i studimit zhvillohet në mënyrë që garantohet thellimi i njohurive dhe, deri diku, edhe zhvillimi i aftësive profesionale, duke qëndruar gjithmonë në sugjerimin tonë (dhe konkluzionit të studentëve, Aneks gjatë vizitës “Minuta Gjuha Greke,” f. 12) për të inkuadruar edhe praktika profesionale në programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Vihet re një mungesë e ndonjë lënde në fushën e TIK, të cilën pedagogët dhe instancat drejtuese e justifikuan duke sugjeruar se aftësi teknologjike praktikohen në çdo lëndë. Gjatë vizitës në IAL, të pyetur se çfarë softuerë përdorin (Aneks gjatë vizitës “Minuta Gjuha Greke,” f. 11), studentët deklaruan se gjatë studimeve të tyre përdorën MS Word, Power Point dhe e-mail. Duke qenë se aftësi kompjuterike të tilla për të përdorur programet e mësipërme kanë gjasa të jenë zhvilluar që nga shkolla e mesme, thellimi i kompetencave të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit erdhi si rrjedhojë e pandemisë dhe nevojave që ajo lindi. GVJ-ja shpreson që rishikimi i kurrikulave në të ardhmën do të marrë parasysh kërkesën për integrimin më të ngushtë të TIK-ut me të nxënëit të gjuhës së huaj dhe përgëzon përfundimin e laboratorit të përkthimit, i cili do të krijojë me siguri kushte të favorshme në këtë drejtim.</p> <p><b>Sugjerim:</b> Të shikohet mundësia për integrimin më të ngushtë të TIK-ut me të nxënëit të gjuhës së huaj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Sipas RVB-së, në përfundim të lëndës, kompetencat dhe aftësitë e pritura (dhe jo vetëm ato që shënohen në planet lëndore, RVJ, Standardi I.3) vlerësohen përmes testimit formues dhe përmbledhës, përgjatë dhe në përfundim të lëndës.</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në përfundim të çështjeve kryesore të lëndëve, pedagogët zakonisht kryejnë një përmbledhje për efekt përsëritjeje të koncepteve dhe çështjeve kryesore, si edhe orientimin e studentëve për provimin përfundimtar të lëndës (<i>Aneks 2.1.6. "Silabët"</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Programit të studimit nuk i mungojnë orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës (<i>Aneks Nr. 3.14.3 / 3.14.4 - Raporti Vjetor i Departamentit të Gjuhës Greke, viti akademik 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në mendimin e RVB-së, programi përzien formim teorik me përvoja praktike (<i>Aneks Nr. 1.7, "Rregullore e Përgjithshme e UT-së;" Nr.2.1.1, "Rregullore e programit të studimit Cikli i Parë, Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek"</i>). GVJ-ja i bashkohet këtij mendimi, pasi reflektoi mbi silabët e paraqitur. Kompetenca të transferueshme zhvillohen edhe përmes bashkëpunimeve në grup, si element që praktikohet në disa lëndë (<i>Aneks Nr. 2.1.6, "Syllabuset e lëndëve të programit të studimit Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek"</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Intervistat me studentet dhe personelin akademik i treguan GVJ-së se personeli akademik krijon kushte dhe klimë kurajuese për zhvillimin e ideve inovative të studentëve, pavarësisht kufizimeve në punimet shkencore që u prekën më lart. Disa pedagogë kanë bashkëpunuar me studentë në zhvillimin e ide-projekteve dhe prezantimin e tyre nëpër konferenca shkencore (<i>Evidenca 35.5</i>), jo rrallë edhe me financime të jashtme, tregues, ky, i një niveli mjaft të lartë, (<i>bursa nga EGNA LOW GROUP shpërndarje bursash nga ambasada Greke, shih edhe Anekse Nr. 3.14.3 / 3.14.4. – Raporti Vjetor i Departamentit Gjuhës Greke, viti akademik 2019-2020, 2021-2022</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Mbështetja institucionale drejt studentëve të programit të studimit u cilësua si e mjaftueshme nga GVJ-ja, sipas arsytimit të RVB-së dhe evidencave të paraqitura (<i>Aneks Evidenca 35.5</i>), por jo të qendrueshme, pasi nuk paraqiten zërat përkatëse për financim të këtyre aktiviteteve. Për mbështetjen financiare të studentëve, GVJ-ja nuk mund të gjykonte, pasi evidencat e cituara në RVB nuk ishin në listën e anekseve dhe ato që ishin (<i>Anekse 3.14, "Raporti i veprimtarisë mesimore kërkimore -shkencore per vitin 2020-2021" dhe 3.14.1 "Raporti vjetor 2018-2019"</i>) nuk i përkisnin Departamentit, por gjithë institucionit.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Mobilitetet e personelit akademik nëpër universitete-partnerë të institucionit (<i>Aneks gjatë vizitës "Mobilitet i pedagogut"</i>) kanë mundur ndërtimin e formave të mësimdhënies me institucionet homologe në Greqi, duke mundur edhe mobilitetin e studentëve (<i>Aneks gjatë vizitës "Mobiliteti Studenti me ERASMUS+"</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mobilitetet e personelit akademik nëpër universitete-partnerë të institucionit (<i>Aneks gjatë vizitës "Mobilitet i pedagogut"</i>) kanë mundur ndërtimin e formave të mësimdhënies me institucionet homologe në Greqi, duke mundur edhe mobilitetin e studentëve (<i>Aneks gjatë vizitës "Mobiliteti Studenti me ERASMUS+"</i>).</p>			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



Shkalla e përmbushjes së standardit			X	
-------------------------------------	--	--	---	--

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Programi mbyllet me mbrojtjen e diplomës para një komisioni të posaçëm me përbërje nga 3-5 pedagogë ( <i>Evidenca 19.3</i> ). Rregullat dhe procedurat përkatëse ndjekin parashikimet institucionale ( <i>Aneks Nr. 1.7, "Rregullore e Përgjithshme e UT-së (nenet 59-60)</i> ), të njësisë kryesore dhe të vetë departamentit për programin e studimit ( <i>Aneks Nr. 1.8, "Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja; Aneks Nr. 3.21, Rregullore e diplomimit për programin e studimit Cikli i Parë, Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Drejtuesi i temës përcaktohet me vendim departamenti dhe mbështetja që i ofron studentit të mbikqyrur është përgjithësisht e mjaftueshme ( <i>Aneks Nr. 1.7, "Rregullore e Përgjithshme e UT-së (nenet 59-60);" Nr. 1.8, "Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja;" Nr. 3.21, "Rregullore e diplomimit për programin e studimit Cikli i Parë, Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek"</i> ), siç u konfirmua edhe nga njëra prej studenteve të intervistuar (pasi një tjetër nuk kishte arritur ende në fazën e diplomës, por kishte ardhur, pas një shkëputjeje, për t'u angazhuar sërish).
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Rregullat e mësipërme parashikojnë se, kur, në vend të mbrojtjes së diplomës realizohet provim i përgjithshëm përfundimtar, komisioni i posaçëm "vlerëson punimin referuar njohurive të përfuara nga studentët në tre vite akademike, mbi bazën e zhvillimit të temës" dhe pastaj harton tezën ( <i>Aneks Nr. 3.21, "Rregullore e diplomimit të programit të studimit Cikli i Parë, Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek"</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Sipas RVB-së, " <i>Mentorimi i studentit bëhet nga pedagogu përkatës i miratuar nga departamenti, përmes sistemit të tutorimit. ... Pedagogu udhëheqës e orienton dhe e ndihmon studentin jo vetëm në fillim për përcaktimin e temës së diplomës, por edhe gjatë punës dhe zhvillimit të temave duke zhvilluar seanca metodologjike orientuese me grupin e studentëve që ai udhëheq përmes orëve të tutoriatit/këshillimit</i> ". GVJ-ja nuk e kishte të mundur ta verifikonte me evidenca konkrete (citimi i rregullorëve nga ana e GVB-së nuk përbën dëshmi të praktikimit të parashikimeve). Nga dy studentet e intervistuar, njëra ishte në procesin e përzgjedhjes së temës, ndërsa tjetra ende nuk ishte në këtë fazë, rrjedhimisht deklaratat e tyre se parashikimet zbatohen ishin "me të dëgjuar." Sugjerohet që seancat metodologjike të dokumentohen plotësisht, duke përfshirë këtu edhe silabusin përkatës.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi	<b>Sugjerim:</b> Dokumentimi i seancave metodologjike duke ndjekur edhe një silabus konkret.



është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.									
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi i provimit përfundimtar të formimit dhe i punimit të diplomës bëhet me notë, siç u konstatua edhe gjatë vizitës pranë sekretarisë mësimore.								
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Pas përfundimit të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe shtojcë të saj (Evid. 1.1., Statuti i UT-së, Neni 110-111; Nr.1.7, "Rregullore e Përgjithshme e UT-së, Neni 63; Nr. 2.1.1., "Rregullore e programit të studimit Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek; Nr. 2.1.3, "Suplementi;" Nr. 2.1.2, "Modeli i diplomes;" Nr. 3.26, "Dosja me elementet perberes te diplomave te ciklit te pare"). Te diplomuarve ekselentë (me mesatare 10/10) i jepet medalje ari, ndërsa atyre me mesatare > 9.0/10 i akordohen çertifikata "Student i Shkëlqyer" në zbatim të parashikimeve përkatëse staturore dhe rregullatore të Universitetit (Aneks Nr. 1.1, "Statuti i UT-së, Neni 113; Nr. 1.7, "Rregullore e Përgjithshme e UT-së, Neni 66).								
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas diplomimit, të diplomuarve të interesuar u vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar prej tyre, me sullabuset përkatëse, sipas pohimeve të RVB-së, i cili citon te një Evidencë (Evidenca 3.26 Dosja me elementet perberes te diplomave te ciklit te pare) të paparaqitur në anekset e dorëzuara (krhs. Aneks Nr. 2.1.3 Suplementi).								
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Ruajtja e dokumentacionit të studentit dhe përdorshmëria e dokumentacionit të arkivuar u gjetën konform parashikimeve ligjore dhe staturore dhe rregullative të institucionit të transferuara këtu: Aneks Nr. 2.1.1, "Rregullore e programit të studimit Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek."								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit	Institucioni, përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore, mbledh, ruan dhe përditëson rregullisht të dhënat për çdo anëtar të personelit akademik që

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 34

<p>akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>përfshihet në realizimin e programin të studimit, si dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit. Zyra menaxhon dosjet e personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. <i>(Kontratat e punës të personelit nga vizita e GVJ; Evidenca 4.1, Vendim nr. 2, dt. 24.01.2022 'Për miratimin e manualit mbi Punësimin e Personelit në Universitetin e Tiranës' dhe publikimi në APP).</i></p> <p>Departamenti ruan dhe përditëson rregullisht (çdo vit akademik) dokumentet përkatëse si dhe (ngarkesën mësimore) për çdo semestër dhe vit akademik për secilin anëtar të personelit të përfshirë në programin e studimit <i>(sipas Tabela 1, 2 dhe 4).</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Departamenti në përputhje me nevojat e programit të studimit dhe duke u bazuar në politikat dhe legjislacionin përkatës për procedurën e rekrutimit, paraqet kërkesën si dhe kriteret e nevojshme në instancat përkatëse të IAL-së. Procedura e rekrutimit të personelit akademik në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe realizohet në zbatim të bazës ligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore të institucionit.</p> <p><i>(Evidenca 1.1, Statuti I IAL, Kreu 5, Personeli i UNITIR, Neni 67, 68, 69: Punësimi i Personelit Akademik, Dosjet e personelit nga vizita e GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore; Evidenca 4.1, Vendim nr. 2, dt. 24.01.2022 «Për miratimin e manualit mbi Punësimin e Personelit në UT» dhe publikimi në APP; Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Pas evidentimit të nevojave për personel akademik për realizimin e Programit të Studimit, ndiqen procedurat e nevojshme të bazuara në kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore.</p> <p><i>Kodi i Punës, Ligji Nr. 80/2015, aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe aktet e brendshme rregullative të institucionit.</i></p> <p><i>(Evidenca 1.1, Statuti I IAL, Kreu 5, Personeli i UNITIR, Neni 67, 68, 69: Punësimi I Personelit Akademik; Evidenca 4.1, Vendim nr. 2, dt. 24.01.2022 «Për miratimin e manualit mbi Punësimin e Personelit në UT» dhe publikimi në APP.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedura e rekrutimit të personelit kryhet në zbatim të legjislacionit përkatës. Bëhet përpjekje që gjatë vendosjes së kritereve specifike si dhe gjatë rekrutimit, kandidati të jetë sa më afër nevojave specifike të departamentit, por në kushtet e sotshme nuk është gjithmonë e mundur, për shkak të mbylljes së doktoratave për një kohë të gjatë si dhe mungesës së specialistëve në këtë fushë. I jepet prioritet nivelit të studimeve, përputhjes së interesave shkencore të kandidatit me lëndën, përvojës së mëparshme akademike, punës shkencore etj. <i>(Evidenca 2.1.7 CV-te e stafit akademik të programit të studimit; Kontratat e punës të personelit nga vizita e GVJ në Zyrën e Burimeve.)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Institucioni ka krijuar mjedis të përshtatshëm për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Personeli trajtohet pa dallime dhe diferencime të dukshme. Ekziston frymë bashkëpunimi si brenda anëtarëve të Departamentit, ashtu edhe me kolegët e programeve të tjera të studimit si dhe me organet drejtuese të institucionit, duke krijuar mundësi të barabarta për çdo anëtar si për realizimin e procesit mësimor ashtu edhe për ngritjen e nivelit profesional - akademik personal. Ka pjesëmarrje të barabartë në sugjerimin e ideve të reja. Akses i barabartë për publikimin e punës shkencore në revistën e FGJH-së. Akses i barabartë në trajnime, etj. ( <i>Vizita e GVJ-së në institucion</i> )
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni tregon kujdes të veçantë për zhvillimin e mëtejshëm akademik dhe profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. Kjo evidentohet nga CV-të e pedagogëve ( <i>Evidenca 2.1.7. CV-të e stafit akademik.</i> ), ku vihet re puna kualifikuese gjatë viteve dhe ngritja e nivelit akademik të tyre. Pjesëmarrja në evenimente shkencore, botime artikujsh, pjesëmarrje në mobilitete, marrja e gradave shkencore (2 prof. Asoc dhe 4 dr). Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar me intitucione të tjera. Organizimi i aktiviteteve të ndryshme (Evid. 3.14.2 <i>Aktivitetet, konferenca, antologjia, workshop, shperndarje bursash.</i> ) etj. Institucioni financon pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete shkencore (sipas deklaramit të dekanes së FGJH gjatë takimit me GVJ, por në fakt mungon evidenca e posaçme nga materjalet në dispozicion të GVJ.). ( <i>Tabela 20, Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të fakultetit</i> ), ( <i>Tabela 17, Të dhëna të plota për platformat on-line/ struktura e teknologjisë së informacionit/biblioteka/ biblioteka on-line</i> )
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Paralelisht me pajisjen e institucionit me materiale të ndryshme inovative të mësimdhënies, si dhe të përdorimit të teknologjive të reja siç janë dërrasat ndëraktive, kabineti i fonetikës etj, institucioni organizon seminare dhe trajnime për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin profesional të personelit mbi metodat inovative të mësimdhënies, si dhe të përdorimit të teknologjive të reja si organizimi i orëve të hapura për shkëmbim eksperience. ( <i>Nga vizita e GVJ. Mungon evidenca e posaçme.</i> ) Ka gjithashtu, pjesëmarrje në mobilitete, ( <i>Evid. shitesë 5.Marreveshje mobiliteti, 6.Mobilitet i pedagogut</i> ) organizime të konferencave dhe kongreseve shkencore, etj. ( <i>Evid. 4.3 Lista e perditesuar me inventarin e laboratoreve te rinj; Evid. 3.17 Strategjia e teknologjise se inovacionit ne mesimdhënie e nxenie; Udhëzues për Përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të	Personeli akademik i Departamentit të gjuhës greke përbëhet nga dy profesorë të asociuar dhe katër doktor shkencash. ( <i>Tab. 1, 2</i> ) Përmbajtja e CV-ve të tyre dhe aktiviteti i tyre akademiko-shkencor tregon një angazhim optimal për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit të ciklit të

programeve të studimeve të ciklit të parë.	parë. Angazhimi dëshmohej edhe nga vlerësimi i performancës së personelit akademik nga vetë studentët. (Evidencat 3.13 Formular vlerësimi nga personeli akademik dhe formular vlerësimi nga studentet i mesimdhënies në distance dhe 3.13.1 Raporti përmbledhës mbi pyetëtorin e mesimdhënies në distance-Komentet përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Programi i studimit «Gjuhë Greke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek, përkthim dhe interpretim» zhvillohet në mjediset e FGJH të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive të nevojshme. Objekti është rikonstruktuar disa herë dhe është në gjendje shumë të mirë. (Tabela 16, Vizita e GVJ në Institucion.) Edhe pse në RVB shkruhet «Objekti është ndërtuar me materiale cilësore dhe që plotëson kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ duke shmangur elementët e rrezikshmërisë. Lidhur me akustikën në mjediset e mësimi, izolimin nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës janë bërë deklaratimet nga inxhinier i licencuar se të gjitha këto elementë janë brenda standardeve të përcaktuara në ligj dhe kuadrin rregullator», në materjalet që janë vënë në dispozicion të GVJ-së nuk ekziston një deklaratë e tillë.</p> <p>Mjediset mësimore në shërbim të këtij program studimi, përbëhen nga auditorë me kushte të përshtatshme, laboratorë për lëndët laboratorike të përkthimit, laboratorë e kompjuterëve (secili student ka në dispozicionin e tij një kompjuter elektronik me programe / software komerciale, por edhe me burime të hapura, qasje në internet, memorie përkthimi dhe mjete të tjera përkthimi, si dhe një larmi burimesh elektronike). Zyrë për personelin akademik, dy biblioteka (Salla Argjiro dhe salla Rozafa), sallë konferencash, mjedise mbështetëse (tualet), etj. (Evid. 4.5 realizimi i buxhetit 2018 dhe parashikimi i buxhetit 2019, evid. 4.3. Lista e përditësuar me inventarin e laboratorëve të rinj, Vizita e GVJ në Institucion.)</p> <p><b>Sugjerim:</b> Instancat organizuese të programit të studimit të mbajnë dokumentet zyrtare të inxhinierëve në lidhje me përmbushjen e standardeve të mjediseve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit</p>	<p>Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të plota dhe të përshtatshme për akomodimin e studentëve dhe personelit akademik. Mjediset mësimore në shërbim të këtij programi studimi, auditorë leksionesh, seminaresh dhe laboratorë, janë me hapësira të mëdha dhe të mjaftueshme për studentët e këtij programi. Janë të pajisura me teknologji moderne, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik</p>


mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	e praktik. Në laboratorët e kompjuterëve (secili student ka në dispozicionin e tij një kompjuter elektronik me programe / software komerciale por edhe me burime të hapura ( <i>Vizita e GVJ në Institucion.</i> )			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Mjediset mësimore në shërbim të këtij program studimi, auditorë leksionesh, seminaresh dhe laboratorë, janë të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi si kompjutera, projektor, webcam, kufje, foni dhe njësi përkthimi. Gjithashtu, pajisja e auditorëve me dërrasa interactive (2022) dhe lidhja wifi (free) në të gjitha mjediset e FGJH-së ndihmon zhvillimin e mësimin interaktiv me metodologjitë e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies ( <i>Evid. 4.3 Lista e përditësuar me inventarin e laboratorëve te rinj, Vizita e GVJ në Institucion.</i> )			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Institucioni disponon laboratorë informatike të cilët shërbejnë për nevojat didaktike të studentëve. Në këtë laborator janë të vendosur disa kompjutera, në të cilët studentët mund të përdorin programet dhe mjetet mësimore, apo motorët e kërkimit për të shfrytëzuar literaturën online. ( <i>Evidenca 4.6 Strategjia e teknologjisë dhe inovacionit në mësimdhënie e nxënie fq. 11-12)(Tabela 16).</i> Në 2 bibliotekat (Salla Argjiro dhe salla Rozafa) gjenden kompjutera në dispozicion të studentëve për të kryer veprimtari të ndryshme. ( <i>Evidenca 4.4 Rregullorja e bibliotekës, evid. 4.3 Lista e perditësuar me inventarin e laboratoreve te rinj.</i> )			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Institucioni, ku zhvillohet programi i studimit nën vlerësim, garanton kapacitete të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e veprimtarive praktike në funksion të programit të studimit siç u përmend edhe në pikat e mësipërme. ( <i>Tabela 16).</i> Programi i studimit nën vlerësim nuk përmban praktika profesionale.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Institucioni vë në dispozicion të studentëve për këtë program studimi dy biblioteka Bibliotekën Nr. 1 “Argjiro” dhe Biblioteka Nr.2. “Rozafa”. ( <i>Evid. 3.15.3 Fondi, Biblioteka FGJH)</i> ( <i>Evidenca 4.4 Rregullore e brendshme e bibliotekës së FGJH-së</i> ). Gjithashtu, studentët kanë akses të plotë edhe në bibliotekën e Fakultetit të Historisë dhe Filozofisë i cili gjendet në të njëjtën godinë. Ata kanë të drejtë të anëtarësohen në bibliotekë dhe të përdorin

barabartë nga studentët e programit të studimit.	literaturën, si fizike ashtu edhe atë elektronike. ( <i>Vizita e GVJ në Institucion.</i> )
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Studentët e këtij programi studimi përveç bibliotekave të tjera të institucionit, kanë akses të plotë edhe tek Biblioteka e Departamentit që gjendet në zyrën e personelit akademik të Departamentit të gjuhës greke. Këtu mbahen librat dhe literatura specifike që përdoret për nevojat e Programit të studimit. Për pasurimin e kësaj biblioteke me literaturën e përshtatshme kanë kontribuar vetë personeli akademik si dhe Fondacione Greke si mbështetëse të këtij programi studimi siç është Fondacioni Onasis. (<i>Evidenca 3.15.2 Liste librash, biblioteka e departamentit. (Vizita e GVJ në Institucion.)</i>.)</p> <p>Nga vizita e GVJ-së në bibliotekën ku mbahet fondi i librave në gjuhën greke (total 778 nga <i>evidenca 3.15.3</i>) u konstatua se shumica e librave janë botime të vjetra dhe tituj librash që nuk kanë lidhje me programin në fjalë. Natyra specifike e këtij programi ka nevojë për literature shtesë të specifikuar.</p> <p>Nga kartelat e huazimit të librave u verifikua frekuentimi i ulët i bibliotekës nga studentët.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar kushtet për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. (<i>Evidenca 3.15 Libraria digjitale JSTOR</i>). Të gjithë studentët mund ta përdorin librarinë digjitale për studimet dhe kërkimet e tyre (<i>Vizita e GVJ në Institucion.</i>). Megjithatë, biblioteka nuk është e pajisur me aksesorë aksesshmërie për studentë me paaftësi. Strategjia e Fakultetit për gjithëpërfshirjen e cila u dorëzua GVJ-së gjatë vizitës është një hap i rëndësishëm, por hap i parë.</p> <p><b>Sugjerim:</b> Në kuadrin e strategjisë së gjithëpërfshirjes së Fakultetit, të hartohet, buxhetohet dhe implementohet një plan pajisjeje të bibliotekës me teknologji asistuese për studentët me paaftësi ose aftësi të kufizuara.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me disa kompjutera në të cilët studentët kanë akses dhe mund ti përdorin për të shkruar punimet e tyre duke shfrytëzuar njëkohësisht edhe literaturën on-line nga motorët e kërkimit (Google). Gjithashtu, mund të kenë akses te Fondi i Bibliotekës i cili paraqitet në bazën e të dhënave elektronike përmes regjistrimeve në programin e katalogimit të përbashkët elektronik. Biblioteka disponon materiale audio-vizuale në fondin e saj dhe pajisjet e nevojshme për shfrytëzimin e tyre. (<i>Vizita e GVJ në Institucion.</i>)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Fondi i Bibliotekës së FGJH pasurohet me materiale shqip dhe në gjuhë të huaja nëpërmjet blerjeve, shkëmbimit, dhuratave dhe abonimeve. Në RVB-në shkruhet se «<i>Në këtë drejtim, në bazë të përvitshme Departamenti ka marrë vendime për të kërkuar pasurimin e titujve të rinj dhe librave me tituj të rëndësishëm në fushën e gjuhësisë dhe letërsisë greke që janë themelorë për programin e studimit</i>». Tek materialet në dispozicion të GVJ-së nuk kemi ndonjë evidencë për plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit në fjalë. Në (<i>ev. 3.15.1 Librat të shtuar 2019-2020</i>) nuk ka libra për këtë program studimi.</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i funksionimit të bibliotekës përcaktohet në <i>nenin 25 të Rregullores së brendshme të Bibliotekës së FGJH (Evidence 4.2.)</i> dhe është i përshtatshëm me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Biblioteka është e frekuentueshme gjatë gjithë vitit, përjashto ditët e festave zyrtare. Është në shërbim të studentëve nga e hëna në të premte, gjatë orareve 08:00-16:30. Ky orar është edhe i afishuar në hyrje të bibliotekës. (<i>Nga vizita e GVJ</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>		<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p><b>Standardi IV.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni mban regjistrat përkatëse me të dhënat specifike mbi regjistrimin e studentëve, numrat e matrikullimit, etj, që nga dita e regjistrimit të tyre në programin e studimit deri në diplomimin e tyre. Bazuar në udhëzimet e Rregullores së UT (<i>Evid. 1.7</i>), dhe në Rregulloren e FGJH (<i>Evidenca 1.8</i>) pranë Sekretarisë mësimore mbahet një regjistër, në të cilin hidhen të dhënat e studentit dhe nënshkrimi i këtij të fundit në momentin e regjistrimit pranë institucionit. Përpunimi i të dhënave të studentëve sipas përcaktimeve më sipër bëhet në përputhje të plotë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale <i>Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008. (Vizita në institucion)</i>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Dokumentacioni në lidhje me aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit që nga rekrutimi i tyre dhe në vazhdim menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore e Institucionit. Kjo zyrë administron dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Në dosjet personale gjenden kontratat e punës, diplomat dhe titujt akademik, CV-të dhe të gjitha informacionet e tjera që kanë të bëjnë me arritjet akademiko-shkencore të personelit. [<i>Evidenca 1.1, Statuti I IAL, Kreu 5, Personeli i UNITIR, Neni 67, 68, 69: Punësimi I Personelit Akademik, Dosjet e personelit nga vizita e GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore</i>]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>I gjithë dokumentacioni i Institucionit është i aksesueshëm si nga personeli akademik ashtu edhe nga studentët në bazë të <i>Ligjit nr. 119/2014 Për të drejtën e informimit</i>. Të interesuarit duhet ti drejtohen zyrës përkatëse për të marrë informacionin e duhur. (<i>3.20 Programi i transparencës per UT. Vizita e GVJ-së në institucion</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe</p>	<p>Institucioni në këtë moment nuk disponon platforma interaktive. Është i vetëdijshëm se mënyra e menaxhimit të dokumentacionit si dhe të procesit të informimit të studentëve për rezultatet e tyre nuk është e duhura dhe bën përpjekje për vendosjen e platformave që mundësojnë forma të komunikimit</p>






shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. ( <i>Vizita e GVJ në institucion</i> )  <b>Sugjerim:</b> Të shikohet mundësia e përdorimit të ndonjë platforme interaktive.			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Platforma Microsoft Office 365 u përdor me sukses vetëm gjatë periudhës së pandemisë. Nga komunikimet me drejtuesit e programit gjatë vizitës së GVJ-së në FGJH u përcoll informacion në lidhje me efikasitetin dhe përdorimin aktiv e në kohë reale të sistemit të menaxhimit. (Minutat e vizitës së GVJ).			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja zyrtare Web e FGJH-së <a href="http://www.fgjh.edu.al/">http://www.fgjh.edu.al/</a> i adresohet personelit akademik, studentëve por edhe publikut të gjerë. Aty publikohet informacion në shqip dhe në anglisht dhe ka lidhje me strukturën dhe funksionimin e fakultetit, pranimit, regjistrimet, struktura akademike, orari mësimor për studentët, programet e studimit, programe shkëmbimi, kërkimi shkencor dhe njoftime. ( <i>Adresa e website është <a href="https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-greke/">https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-greke/</a>.</i> ) Departamenti i Gjuhës Greke publikon materjale edhe në faqet e mediave sociale që disponon si Facebook dhe Instagram.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni harton çdo fillim viti raportin financiar si pjesë e Raportit Vjetor të FGJH-së, ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i tarifës së shkollimit, si dhe kosto financiare mesatare për student. ( <i>Evidenca 4.7 Kostoja e studimeve për ciklin e parë Bachelor për vitin akademik 2018-2019, Evidenca 4.8, Buxheti i Shtetit, Raporti i Auditimit, evidenca 4.9 Miratimin e detajimit të grantit të mësimdhënies, evidence 4.10, Pasqyrat financiare të vitit 2019, evidenca 4.11 Përcjellja e raportit përfundimtar të auditimit bazuar në planin vjetor 2020, evidence 4.12 Përgatitja e buxhetit të konsoliduar për vitin 2020, evidenca 4.13 Për përgatitjen e buxhetit të konsoliduar për vitit 2021, evidence 4.14 Realizimi i buxhetit 2018 dhe parashikimi i buxhetit 2019, evidence 4.15 Realizimi i të ardhurave për vitin 2020).</i> )

<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit del se për hartimin dhe miratimin e projekt- buxhetit, institucioni fillimisht merr parasysh nevojat e njëjësive bazë dhe kryesore të institucionit. Në përputhje me përcaktimet ligjore, <i>Neni 52/1/a i Ligjit Nr. 80/2015</i>, njësitë kryesore dhe njësitë bazë dërgojnë kërkesat e tyre lidhur me hartimin e projekt-buxhetit. Në përputhje me nevojat, interesat e institucionit, dhe planin strategjik të zhvillimit bëhet miratimi i kërkesave të tyre, të cilat reflektohen më pas në zëra konkretë të buxhetit.</p> <p>Financimi, menaxhimi dhe administrimi i programit të studimit nën vlerësim pasqyrohet në Pasqyrat Financiare të FGJH-së. Zyra e Financës është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit. Ajo ndjek zbatimin e të gjithë procedurave financiare për realizimin e të ardhurave, kryerjen e investimeve, shpenzimeve, pagesave, mbajtjen e dokumentacionit kontabël dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore.</p> <p><i>(Evidenca 4.7 Kostoja e studimeve për ciklin e parë Bachelor për vitin akademik 2018-2019).</i></p> <p><i>Evidenca 4.8, Buxheti i Shtetit, Raporti i Auditimit, evidenca 4.9 Miratimin e detajimit të grantit të mësimdhënies, evidenca 4.10, Pasqyrat financiare të vitit 2019, evidenca 4.11 Përcjellja e raportit përfundimtar të auditimit bazuar në planin vjetor 2020, evidenca 4.12 Përgatitja e buxhetit të konsoliduar për vitin 2020 evidenca 4.13 Për përgatitjen e buxhetit të konsoliduar për vitin 2021, evidenca 4.14 Realizimi i buxhetit 2018 dhe parashikimi i buxhetit 2019, evidenca 4.15 Realizimi i të ardhurave për vitin 2020).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Çdo vit veprimtaria e institucionit i nënshtrohet një auditimi dhe vlerësimi ku dokumentohet gjendja e financimit dhe efektiviteti financiar i tij. Raporti i Auditit financiar shprehet në përgjithësi për plotësimin e objektivave financiare të institucionit dhe përmban informacion të detajuar mbi shkallën e plotësimit të objektivave strategjike të institucionit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, konsolidimin e procesit kërkimor si dhe për një shërbim sa më të mirë studentit.</p> <p>Gjithashtu, Zyra e Financës në bashkëpunim me administratorin e fakultetit përgatisin raporte të ecurisë financiare, duke krahasuar shpenzimet përkatëse me buxhetin e miratuar.</p> <p><i>(Evidenca 4.8, Buxheti i Shtetit, Raporti i Auditimit, evidenca 4.9 Miratimin e detajimit të grantit të mësimdhënies, evidenca 4.10, Pasqyrat financiare të vitit 2019, evidenca 4.11 Përcjellja e raportit përfundimtar të auditimit bazuar në planin vjetor 2020, evidenca 4.12 Përgatitja e buxhetit të konsoliduar për vitin 2020, evidenca 4.13 Për përgatitjen e buxhetit të konsoliduar për vitin 2021, evidenca 4.14 Realizimi i buxhetit 2018 dhe parashikimi i buxhetit 2019, evidenca 4.15 Realizimi i të ardhurave për vitin 2020).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e</p>	<p>Dokumentacioni në dispozicion të GVJ-së është bindës në lidhje me raportet financiare në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi. Institucioni dokumenton raportet financiare për një cikël studimi dhe njëkohësisht planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>




posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	<i>(Evidenca 4.4 Kostoja e studimeve per ciklin e pare Bachelor gjuhe greke. Tabela 18 Të ardhurat e financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit. 4.7 Miratimi i grant-it te mesimdhënie nga buxheti i shtetit 2019. 4.13 Buxheti i te ardhurave per vitin akademik 2020.pdf</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Institucioni reflekton qëndrueshmëri financiare e cila garanton zhvillimin e programit të studimit. Kapacitetet financiare të tij varen jo vetëm nga financimi shtetëror përmes Buxhetit të Shtetit por edhe nga vetfinancimi. <i>(Evidenca 4.7, Miratimin e detajimit të grantit të mësimdhënies, 4.8 Pasqyrat financiare te vitit 2019. evidence 4.9, Përgatitja e buxhetit të konsoliduar për vitin 2020, evidencia 4.10 Për përgatitjen e buxhetit të konsoliduar për vitit 2021, evidence 4.5 Realizimi i buxhetit 2018 dhe parashikimi i buxhetit 2019, evidence 4.15 Realizimi i të ardhurave për vitin 2020).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni zbaton të gjitha procedurat dhe kriteret e përcaktuara në LAL si dhe aktet rregullatore të Ministrisë dhe agjencive kompetente në varësi të saj (QSHA, RASH), që lidhen edhe me politikat studentore nga hyrja në dalje. Pranimi i studentëve të rinj në programet e studimit si dhe mbarëvajtja e vazhdimësisë së studimeve të tyre deri në përfundim bëhet në bazë të politikave dhe procedurave në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Politikat dhe procedurat, që rregullojnë ciklin a plotë akademik të studentëve nga hyrja deri në diplomim dhe më tej, janë të përfshira në rregulloren e programit të studimit, i cili u përpilua në përputhje me legjislacionin në fuqi. <i>(LAL. Evidenca 1.1: Statuti i IAL, Evidenca 1.8: Rregullore e përgjithshme e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Evidenca 2.1.1 Rregullore e Programit të studimit).</i>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë	Programi i studimit është hartuar dhe zbatohet bazuar në legjislacionin në fuqi në fushën e Arsimit të Lartë. Si i tillë, ai garanton të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët që aplikojnë nëpërmjet sistemit të Maturës Shtetërore. Politikat dhe procedurat që ndiqen në vazhdimësi nga hyrja në

kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët e programit të studimit (LAL, Evidenca 1.1: Statuti i IAL, Evidenca 1.8: Rregullore e përgjithshme e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Evidenca 2.1.1 Rregullore e Programit të studimit).			
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit realizohen në përputhje me LAL, Statutin, Rregulloren dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja bën publike në mjediset e tij dhe në faqen elektronike zyrtare hapjen e procedurës së transferimeve dhe regjistrimeve, duke bërë me dije dokumentet e kërkuara dhe gjithë procedurën që do të ndiqet. Gjithashtu, në faqen Web të FGJH gjendet <i>Rregullorja e Diplomimit të Programeve Studimore të ciklit I -Bachelor</i> . (LAL, Evidenca 1.1: Statuti i IAL, Evidenca 1.8: Rregullore e përgjithshme e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Evidenca 2.1.1: Rregullore për organizimin e programit të studimit Bachelor në gjuhë Greke )			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Çdo fillim viti akademik institucioni shpall kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve që do të pranohen në ciklin e parë të studimeve. Procedura e pranimit kryhet përmes sistemit të Maturës Shtetërore në bashkëpunim me MASR-in, dhe në përputhje me kriteret dhe kuotat e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. (Evidenca 5.2: Kuotat dhe kriteret e pranimit. Evidenca 1.1 Statuti i FGJH,)			
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimi bëhet përmes aplikimit nga ana e kandidatëve të interesuar, sipas kriterëve të vendosura nga institucioni dhe brenda afatit të përcaktuar në bashkëpunim me MASR-in. Aplikimi për programin bëhet përmes sistemit të Maturës Shtetërore në përputhje me aktet e nxjera nga MASR për këtë qëllim. Institucioni shpall listën e kandidatëve fitues për programin dhe informacion për raundet në vijim. Në lidhje me studentët e huaj, në vendimin e FGJH-së nr. 148 datë 02. 12. 2021 «Mbi kriteret e pranimit të studentëve... » pika B u referohet kandidatëve që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj dhe pika C u referohet shtetasve të huaj të cilët pranohen sipas kushteve dhe mënyrave të parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe. <a href="https://fgjh.edu.al/pranime/">https://fgjh.edu.al/pranime/</a>			
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Çdo fillim viti akademik Fakulteti i Gjuhëve të Huaja publikon në faqen e tij të Webit: <a href="http://www.fgjh.edu.al">http://www.fgjh.edu.al</a> kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të secilit program studimi. Këto informacione janë transparente dhe lehtësisht të aksesueshëm për të gjithë kandidatët studentë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Kriteret dhe procedurat për përparimin akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, përmbahen në Rregulloren e FGJH-së, në Rregulloren e Departamentit dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Këto informacione janë të aksesueshme për studentët në faqen web të FGJH-së. Në çdo fillim viti akademik, në javën e parë të tij, studentët njihen më gjerësisht me programin e studimit që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, të drejtat dhe detyrimet si dhe mundësitë që ofron ky program studimi. (Evidenca 1.8: Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja 2010, Evidenca 1.9: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njëjësive bazë në UT -Dep.Gj.Greke, Evidenca 2.1.1: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë dhe Qytetërim Grek).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Ky proces realizohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e IAL-së, Rregulloren dhe aktet të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Institucioni publikon në mjediset e tij dhe në faqen elektronike zyrtare <a href="https://fgjh.edu.al/">https://fgjh.edu.al/</a> hapjen e procedurës së transferimeve dhe regjistrimeve. Gjithashtu të interesuarit informohen edhe për dokumentet e kërkuara si dhe për të gjithë procedurën që do të ndiqet. (Evidenca 1.1: Statuti i IAL, Evidenca 1.8: Rregullore e përgjithshme e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja) Evidenca 2.5 Procedura e transferimit të studentit.) Praktikë ekuivalentimi datë 10. 07. 2020 (Evidenca 2.6: Procedura e ekuivalentimit të programeve të mobilitetit të studentit.)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve përmbahen në Statutin e UT-së dhe në Rregulloren e FGJH-së. Në mbledhjen e fillim viti Departamenti informon studentët në lidhje me kriteret e vlerësimit për çdo lëndë dhe tërë studimet e tyre (Evidenca 2.1.1: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë dhe Qytetërim Grek, Evidenca 2.1.6: Syllabuset e lendeve sipas VKM/2018, Vizita e GVJ në institucion.)
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë dhe Qytetërim Grek neni 13 i referohet Procesit të Diplomimit të studentëve. (Evidenca 2.1.1: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë dhe Qytetërim Grek). Gjithashtu, në faqen Web të FGJH gjendet Rregullorja e Diplomimit të Programeve Studimore të ciklit I -Bachelor. Çdo student ka udhëheqësin shkencor të punimit të diplomës, i cili është përgjegjës për përgatitjen e punimit të diplomës dhe për ndjekjen e ecurisë së punimit të diplomës duke dhënë udhëzime të vazhdueshme deri në përfundimin e saj. (Vizita e GVJ në institucion.)
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni	Para perjudhës së plotësimit të formularëve të Maturës Shtetërore Institucioni organizon fushata informimi të maturanëve në funksion të këshillimit të karrierës dhe rekrutimit të kandidatëve për student. FGJH



publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	përdor një larmi mjeteve informimi për publikun. Konkretisht, informon palët e interesuara nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit, rrjeteve sociale, <a href="https://www.facebook.com/departamentigjuhesgreke">https://www.facebook.com/departamentigjuhesgreke</a> fletëpalosjeve, broshurave informative apo ditëve të informimit dhe këshillimit të karrierës me maturanët realizuar në shkollat e mesme, ditët e hapura si dhe ditët e karrierës ku prezantohen programet e studimit, kriteret e pranimit, infrastruktura në funksion të programeve, personeli akademik, mundësitë e punësimit etj. (Materiale të vënë në dispozicion të GVJ-së gjatë vizitës në institucion).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Në çdo fillim viti akademik, në javën e parë organizohet aktiviteti “Njihu me FGJH” ku studentët njihen me Rregulloren, Statutin, Rregulloren e programit, Kodin e etikës, orarin, kalendarin akademik etj. Mjet tjetër i rëndësishëm informimi në kohë reale është edhe faqja zyrtare e FGJH, si dhe rrjetet sociale, stenda e komunikimeve të Departamentit ku afishohet struktura e Vitit Akademik, orari mësimor, njoftime të ndryshme etj. (Evidenca 3.19 Udherrefyesi i studentit, Evidenca 1.8: Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Vizita e GVJ-së në Institucion)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Çdo fillim viti akademik studentët e çdo viti në një takim të posaçëm me personelin akademik dhe personelin ndihmës informohen për strukturën e Vitit Akademik, modulet, lëndët, përmbajtjen e lëndëve dhe veprimtaritë formuese që do të zhvillohen gjatë vitit. Gjithashtu, syllabuset e secilës lëndë dhe kurrikula e programit të studimit prezantohen edhe nga vetë Përgjegjësi i Departamentit dhe pedagogët përkatës. 2.1.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit Bachelor në gjuhë Greke, Vizita e GVJ-së në Institucion)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Departamenti në bazë të statistikave që disponon nga tregu i punës (Evidenca. 1.12 Studimi i tregut të punës për studentët e gjuhëve të huaja 2021.) si dhe nga të dhënat që grumbullon vetë (minutat e GVJ me stafin akademik), informon studentët mbi mundësitë e punësimit që u jep Programi i studimit që kanë zgjedhur të ndjekin. Gjithashtu, Zyra e Këshillimit të Karrierës, si dhe Alumni informon studentët nëpërmjet takimeve të ndryshme si dhe adresës së e-mail në mënyrë të vazhdueshme lidhur me të gjitha mundësitë e punësimit dhe i mbështet ata për t’u integruar në tregun e punës. (Vizita e GVJ-së në Institucion. Evidenca. 1.12 Studimi i tregut të punës për studentët e gjuhëve të huaja 2021.)
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin	Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme lidhur me zhvillimin e procesit mësimor me mënyra të ndryshme. Nëpërmjet njoftimeve të afishuara në ambjentet e Institucionit, nëpërmjet faqes web të FGJH ku jepet

dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	informacion i detajuar lidhur me procesin mësimor, nëpërmjet adresës së e-mailit lidhur me orarin e mësimi, orarin e provimeve, vendin e zhvillimit të provimeve, konsultimeve etj. ( <a href="http://www.fgjh.edu.al">http://www.fgjh.edu.al</a> , <i>Vizita e GVJ-së në Institucion</i> ).			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Informacioni në lidhje me këtë program studimi mundësohet si përmes sistemit të menaxhimit institucional, ashtu edhe përmes mënyrave të përshkruara më sipër, përdorimit të platformës Google, emaileve të studentëve, të Web site të FGJH etj.  <b>Institucioni nuk disponon një sistem dixhital menaxhimi të brendshëm i cili është shumë i nevojshëm, sidomos për studentët në distance.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin dhe profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Institucioni mban statistika vjetore mbi numrin e studentëve të rregjistruar si në vitin e parë, ashtu edhe në vitet e tjera, për çdo program studimi si dhe numrin e studentëve që arrijnë të diplomohen çdo vit. Këto të dhëna ruhen edhe në mënyrë elektronike në zyrën e arkivit të FGJH-së. ( <i>Evidenca tabela 21; Vizita e GVJ-së në sekretarinë mësimore</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria mësimore, bazuar në legjislacionin përkatës, çdo fillim viti akademik rregjistron studentët në vitin e parë të programit të studimit për të cilin kanë aplikuar. Rregjistrimi bëhet në rregjistra të posaçme ku në vazhdim në këto pasqyrohen të gjitha veprimtaritë akademike që kryen çdo student gjatë viteve të studimit. Aty shënohen notat e provimeve, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.  ( <i>Evidenca 1.8 Rregullore e FGJH; Vizita e GVJ-së në sekretarinë mësimore</i> )
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre.	Institucioni disponon statistika mbi ecurinë e studentëve të këtij programi. Sekretaria mësimore, arkivon proces-verbalet e provimeve në përfundim të çdo sesi provimesh dhe bazuar në <i>Udhëzimin e MASR Nr.16, datë 08.07.2019</i> pasqyron vlerësimet e studentëve në regjistrin e arritjeve akademike, në format elektronik si dhe të hedhura me dorë në regjistrin e pajisur nga QSHA ( <i>Regjistër i notave MAP</i> ). ( <i>Vizita e GVJ-së në sekretarinë mësimore</i> )
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të	Sekretaria Mësimore e Institucionit mbledh dhe menaxhon të dhënat e studentëve për çdo program studimi në veçanti. Ruan dhe arkivon dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student të programit të studimit

informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	në rregjistra të posaçme dhe njëkohësisht i arkivon këto të dhëna në mënyrë elektronike për siguri më të madhe. Aksesi në këtë informacion i mundësohet lirisht studentit nga personeli i autorizuar i sekretarisë. (GVJ u njoh nga afër me këto të dhëna gjatë vizitës në sekretarinë e FGJH.) (Evidenca 1.8 Rregullore e FGJH;			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Nga takimi i GVJ-së me stafin akademik dhe drejtuesin e Departamentit të Gjuhës Greke u përment se në analizat vjetore të Departamentit diskutohet për nivelin e arritjeve të studentëve nga hyrja deri tek përfundimi i programit të studimit. Departamenti interesohet vazhdimisht për të marrë informacione edhe rreth punësimit të studentëve se kjo i ndihmon për të studiuar nevojat e tregut të punës. (Vizita e GVJ-së në Institucion)			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në statutin e UT (Evidenca 1.1. Statuti i IAL, Kreu XI, Studentët) parashikohet përfshirja dhe angazhimi i studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të institucionit. Në institucion funksionon Këshilli Studentor i cili ka hartuar rregulloren e tij të brendshme sipas legjislacionit në fuqi (Evidenca 5.5, Rregullore e Këshillit Studentor; Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Aktualisht studentët përfaqësohen në organet kolegjiale brenda institucionit, siç janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>● Senati akademik me dy anëtarë studentë duke respektuar kuotat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi (Aneksi 44 Vendim SA Nr 23 datë 30.10.2020 Mbi përbërjen e Senatit Akademik).</li> <li>● Komisioni i përhershëm i garantimit të cilësisë në Arsimin e Lartë;</li> <li>● Komisioni i përhershëm i marrëdhënieve me studentët;</li> <li>● Këshilli i Etikës.</li> </ul> <p>Nuk është e lehtë që GVJ të evidentojë përfshirjen reale të studentëve në vendimmarrje, sepse nuk disponon fakte konkrete ose evidenca të posaçme. Edhe pse në RVB theksohet se “..kërkesat për realizimin e aktiviteteve të ndryshme apo kërkesa të cilat vijnë nga ta për përmirësimin e shërbimit, trajtohen në mënyrë të veçantë si dhe me prioritet nga FGJH. Gjithashtu</p>




	<p><i>veprimtaritë të cilat iniciohen nga studentet për veprimtari të propozuara nga këshillat, blerje librash, kompjuteri e laptop shkojnë në vlera të larta si është e cituar edhe në realizimin e buxhetit.”</i></p> <p>Nga vizita e GVJ-së dhe minutat me studentët u konstatua lidhja e ngushtë e studentëve të këtij programi me personelin akademik, ndihmesa dhe mbështetja që ata kishin nga personeli, si dhe marrja parasysh e kërkesave dhe propozimeve të tyre për çështje të ndryshme (<i>Evidenca 5.1, Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës; Evidenca 5.6 Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët.</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Greke me profile është hartuar duke respektuar Ligjin Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.</p> <p>Njohja e studimeve të mëparshme përmes transferimit të krediteve të përfuara në një IAL tjetër është e parashikuar në aktet e brendshme rregullatore.</p> <p>(<i>Evidenca 2.18, Tabela 13</i>) (<i>Evid. 1.9 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njesive baze në Ut -Dep. Gj. Greke, Neni 18, Evid. 2.4 Procedure njohjeje dhe ekuivalentim lëndesh</i>)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët kanë të drejtë të japin mendimin e tyre në procesin e hartimit apo rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit. Janë marrë parasysh sugjerimet dhe idetë e studentëve për ndryshimet deri në 20% të programeve të studimit.</p> <p>(<i>RVB dhe minutat e GVJ-së me studentët dhe stafin akademik</i>)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Sipas nenit 56 të Rregullores së FGJH-së, studenti ka të drejtën e ankimimit (a) për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe (b) për rezultatit e provimit. Për rastin (a), ankesa i paraqitet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit brenda 48 orëve - 2 ditëve nga data e zhvillimit të provimit, ndërsa për rastin (b) ankesa i paraqitet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit brenda 24 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit.</p> <p>(<i>Evid. 1.8 Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Evidenca 2.1.1 Rregullorja e Programit të Studimit,</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës si dhe Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët i cili përbëhet nga 4 pedagogë dhe 3 studentë. <i>(Evid, Evid. 5.6 Rregullore e komisionit të mbarevajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët)</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi i GVJ-së me studentët rezultoi që studentët e programit të studimit nën vlerësim janë të kënaqur nga bashkëpunimi që kanë me personelin akademik të këtij departamenti në të gjitha drejtimet. Personeli qëndron pranë studentëve, duke i informuar dhe këshilluar për tema të ndryshme, por rëndësi të veçantë i jepet procesit mësimor dhe përparimit të studentëve. Ata kanë mundësi të adresojnë shqetësimet e tyre tek të gjitha instancat e institucionit edhe nëpërmjet pedagogut përgjegjës për punën me studentët si edhe nëpërmjet Zyrës së Këshillimit dhe Këshillit Studentor. <i>(Vizita e GVJ-së në institucion, minutat me studentët).</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sipas diskutimeve të GVJ-së me faktorë të ndryshëm të FGJH, Zyra e Këshillimit të Karrierës u ofron studentëve këshillim në mënyrë të vazhduar për ti orientuar si gjatë procesit të ndjekjes së studimeve në institucion, ashtu edhe gjatë përfundimit të tyre për ti adresuar në tregun e punës. Studentëve u jepet informacion në lidhje me mundësitë për punësim edhe nga vetë personeli akademik i cili ka kontakte me institucionet që kanë nevojë për specialistë të këtij profili siç janë institucionet arsimore, zyrat e përkthimit etj. <i>(Vizita e GVJ-së në institucion, minutat me studentët).</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Karrierës disponon të dhëna në lidhje me shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të FGJH. Për efikasitetin e programeve të studimit është shumë i rëndësishëm hapi që është ndërmarë për studimin e tregut të punës për studentët e gjuhëve të huaja 2021. Ky studim do të ishte më i përshtatshëm në qoftë se kishte të dhëna për çdo program studimi në veçanti. Nga diskutimi me personelin akademik të Departamentit të gjuhës greke rezultoi një lidhje e personelit me studentët si dhe me të diplomuarit e këtij programi. Ata ndjekin karrierën e studentëve të diplomuar si dhe brenda mundësive të tyre i adresojnë ata në tregun e punës <i>Evid. 1.12 Studimi i tregut të punës për studentët e gjuhëve të huaja 2021.</i></p>			
	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="592 1877 798 1944">Përbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="798 1877 1005 1944">Përbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1005 1877 1212 1944">Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		



Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni po bën përpjekje të dukshme për aplikimin e procedurave dhe politikave për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, si dhe për ngritjen e strukturave analoge në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Nga viti 2018 funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH. Më 2020 është miratuar Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë së UT. (Evidenca 3.5) si dhe <i>Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> . (Evid. 3.7) dhe më 2022 Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë së FGJH (Evid. 3.10), Manual i Sigurimit të Cilësisë (Evide. 3.6.) të bazuara në legjislacionin përkatës (Evid. 3.10 Rregullore per funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH, Evid. 3.8 Per miratimin e koditit te Cilësisë VKM Nr. 531, datë 11.09.2018.).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në institucion funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH sipas Rregullores për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH. (Evid. 3.10). Institucioni ndjek sigurimin e cilësisë me procedurën e vlerësimit periodik, çdo vit, nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve në fund të çdo semestri. Studentët marrin pjesë në vlerësimin e programit të studimit dhe të procesit mësimor si nëpërmjet diskutimeve të hapura, ashtu edhe përmes pyetësorëve të hartuar për matjen e cilësisë. NjSBC përbëhet nga 7 veta personel akademik dhe 2 studentë. (Minutat Gjuha Greke faq. 12); Evid. 3.10 Rregullore per funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH, Evid. 5.3 Vlerësimi i studentëve.)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Institucioni është i vetëdijshëm për nevojën e Sigurimit të Cilësisë së Jashtëm (Evid. 4.12 Mbi Çertifikatën e Akreditimit Insititucional të UT-së. 2018-2022) me qëllim promovimin dhe përmirësimin e cilësisë së Programeve të ofruara. Në shërbim të këtij funksioni hartohet edhe Raporti në fjalë i Vlerësimit të Jashtëm për Akreditimin e Programit të Studimit.

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Siç u përmend edhe tek kriteri nr 1 i këtij standardi, Institucioni është i vetëdijshëm për nevojën e sigurimit të cilësisë dhe e ka të ngritur mekanizmin e kontrollit të saj. Nëpërmjet instrumentave ndjek procedurat periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Çdo vit akademik harton Raportin vjetor për veprimtaritë e kryera FGJH. Në Departamentin e Gjuhës Greke funksionon komisioni i brendshëm i njësisë bazë për Sigurimin e Cilësisë me 4 pedagogë dhe një student të cilët ishin edhe hartuesit e RVB-së.</p> <p><i>1.10 Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera FGJH 2019-2020.pdf</i>. <i>11 Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera FGJH 2020-2021.pdf</i> <i>3.4 Per miratimin e paketes se dokumentnave per sigurimin e cilesise ne UT. pdf</i> <i>Evidenca 3.10 Rregullore per funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


<p><b>Standardi VI.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimeve është përgjegjës për ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë së brendshme në Institucion, mbështetur në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë si dhe Standartet për sigurimin e cilësisë në IAL, ndërsa Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryesisht vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Të dyja njësitë bashkëpunojnë për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë (<i>Evidenca 2.9 Koordinatorët e programeve të studimit dhe përgjegjësit e tyre.</i>) <i>Evidenca 3.5 Rregullore për Sigurimin e Cilësisë</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Ndryshimet e herëpashershme në masën 20% të Programeve të Studimit të Departamentit të Greqishtes janë një tregues që Departamenti shqyrton efikasitetin e Programit të Studimit dhe i përmirëson ato, duke i përshtatur çdo herë më nevojat e studentëve dhe të tregut të punës (<i>Evid. 2.10 Procedura e ndryshimit të kurrikulës, plani i firmosur, Vendimi i Senatit, Evidenca 1.10 Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera FGJH 2019-2020, Evidenca 1.11 Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera FGJH 2020-2021</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Paketa e Instrumenteve të NJSBC është mekanizmi themelor i institucionit për vlerësimin e ecurisë dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit. NJSBC-ja, ka krijuar mekanizëm zyrtar dhe publikon çdo vit raporte mbi rezultatet e procesit të vlerësimit të programit të studimit. (<i>Evidenca 3.5: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë së UT; Evid. 3.10: Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH; Evid. 3.6: Manual i sigurimit të cilësisë; Evidenca 6.1 Paketa e Instrumenteve të</i></p>

	<p><i>NJSBC</i>). Një mënyrë tjetër për rritjen e cilësisë është edhe takimi dhe diskutimi i drejtpërdrejtë i drejtuesve të institucionit me studentët si dhe formularët ose pyetësoret në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit. Institucioni nuk raporton monitorim të mësimdhënies nga të barabartit (peer-to-peer assessment) dhe rrjedhimisht vlerësimet vjetore realizohen vetëm përmes vlerësimit të shërbimeve të pedagogëve nga studentët (<i>Evidence 3.13 Formular vlerësimi nga personeli akademik dhe formular vlerësimi nga studentët i mësimdhënies në distancë.</i>)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e raporteve dokumentohen dhe i komunikohen Drejtuesit të Departamentit dhe anëtarëve të përhershëm të Departamentit në mënyrë që të vlerësohen dhe interpretohen, për ti ardhur në ndihmë përmirësimit të programit të studimit. Ato u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për shqyrtim dhe implementim. Në takimin e GVJ-së me drejtuesen e NJSBC-së pyetjes së ekspertëve: -“Në momentin që raportoni rezultatet, a janë marrë masa?” Përgjigja ishte se -“rruga e ndjekur është: Raporti i dërgohet Dekanit i cili ia përcjell shefit të njësisë bazë dhe ai respektivisht anëtarëve, të cilët duhet të reflektojnë në lidhje me problematikën në fjalë”. (<i>Minutat Gjuha Greke faq. 13</i>); (<i>Evidenca 1.6: Strategjia e zhvillimit të departamentit të Gjuhës Greke, pika 6, Vizita e GBJ dhe takimi me drejtues të NJSBC</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Nga evidencat në dispozicion të GVJ-së, Raportet e vlerësimit përfshijnë kryesisht rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe jo plotësisht masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. (<i>Evidenca 91, RVB, evid. 3.13 Formular vlerësimi nga personeli akademik dhe formular vlerësimi nga studentët i mësimdhënies në distancë</i> (vlerësim i cili i referohet Fakultetit dhe jo në veçanti programit të studimit) dhe <i>evid. 3.13.2 Vlerësimi i studentëve që janë diplomuar, 3.14 Raporti i veprimtarisë mesimore kerkimore -shkencore per vitin 2020-2021. 3.14.1 Raporti vjetor 2018-2019. 1.10 Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera FGJH 2019-2020. 1.11 Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera FGJH 2020-2021.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plotësisht përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.3</b>  <b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë</p>	<p>Për të vlerësuar ecurinë e programit të studimit, NJSBC-ja monitoron rregullisht realizimin e programit dhe rezultatet e studentëve të arritura në procesin mësimor. Të gjitha këto të dhëna përfshihen në raportin vjetor të vetëvlerësimeve të brendshme periodike të Departamentit, si dhe në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit. (<i>Evid. RVB-Departamenti i Gjuhës Greke</i>).</p>



<p>informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit Zyra e NJSBC përdor metodologjitë e vlerësimit dhe instrumentet e posaçme të matjes. Mënyra dhe procesi i vlerësimit janë paraqitur në rregulloret e kësaj njësie. <i>(Evidenca 6.1 Paketa e Instrumenteve të NJSBC; Evid. 3.10: Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH; Evidenca 3.5 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit, institucioni mer informacione të drejtpërdrejta nga raportet semestrale dhe vjetore që hatrtohen nga Departamenti siç janë përqindja e kalueshmërisë, nota mesatare, apo realizimi i objektivave të programit të studimit. Të dhëna nga anketimet, plotësimet e formularëve të vlerësimit, intervistave, vëzhgimeve, analizave bibliometrike etj. Gjithashtu, meren parasysh treguesit e përcaktuar në Planin Strategjik të Zhvillimit të FGJH, në Planin Strategjik të Kërkimit Shkencor dhe në Raportin vjetor të FGJH-së <i>(Evidenca 3.5 Rregullore për sigurimin e cilësisë; Evid. 3.10: Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH; Evidenca 3.13: Formular vlerësimi nga personeli akademik dhe formular vlerësimi nga studentet i mesimdhënies në distancë.)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve</p>	<p>Institucioni përdor si metoda të drejtpërdrejta, ashtu edhe të tërthorta të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë në këtë program studimi. Duke pasur të diplomuar në këtë program studimi, është e mundur të grumbullohen të dhëna nga intervista me të diplomuarit si edhe me punëdhënësit. Siç u përshkrua edhe më sipër, në takimet e ndryshme me personelin akademik dhe studentët merren të dhëna për cilësinë e programit me metoda të tërthorta. Një tjetër burim të dhënash janë bashkëbisedimet dhe diskutimet mbi cilësinë e programit të studimit me partnerë dhe bashkëpunëtorë të ndryshëm Brenda dhe jashtë vendit me të cilët Departamenti i gjuhës greke ka bashkëpunime <i>(Evidenca 3.13.2 Vlerësimi i studentëve që janë diplomuar; Evidenca 3.5 Rregullore për sigurimin e cilësisë; Evid. 3.10: Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH).</i></p>




e kompetencave të përfuara nga ky program.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi VI.4


**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni e ka të përcaktuar në Statutin e tij, në Rregulloren e FGJH dhe në Rregulloren e programit të studimit përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidenca 1.1 Statuti i IAL; Evidenca 1.8: Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja; Evidenca 1.6: Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Gjuhës Greke, faq. 6-7)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në FGJH funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila bashkëpunon me Komisionin e Përhershëm të Cilësisë së UT. Këto janë dy instancat kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit të cilat janë në bashkëpunim të vazhdueshëm me instancat më të larta të institucionit si dhe me instancat varëse të tyre të parashikuara në kapitullin 2 të Manualit të Cilësisë. Drejtuesit e departamenteve, Grupet e Vlerësimit të Brendshëm të tyre, studentët si dhe bashkëpunëtorë të jashtëm koordinojnë përpjekjet për rritjen e cilësisë së programeve të studimit. <i>(Evidenca 3.5: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë së UT; Evid. 3.10: Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH; Evid. 3.6: Manual i sigurimit të cilësisë; Evidenca 6.1 Paketa e Instrumenteve të NJSBC; Takimi i GVJ me drejtuesit e NJSBC).</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Siç u përmend edhe më lart, strukturat, njësitë dhe autoritetet konkrete të përfshira në sigurimin e brendshëm për këtë program studimi, detyrat dhe përgjegjësitë janë përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Institucioni ka të ngritura strukturat përkatëse që shkojnë deri në nivel Departamenti. Sipas të dhënave nga takimet në institucion dhe akteve të NJSBC, vlerësimi zhvillohet në bashkëpunim me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. Konkretisht, komisioni për raportin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit në fjalë përbëhet nga personel akademik, personel administrativ dhe studente. <i>(Evidenca 3.5: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë së UT; Evid. 3.10: Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH; Evid. 3.6: Manual i sigurimit të cilësisë; Evidenca 6.1 Paketa e Instrumenteve të NJSBC; Takimi i GVJ me drejtuesit e NJSBC).</i>



<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Për sigurimin e cilësisë, institucioni ka ngritur strukturat përkatëse në zbatim të akteve rregullore, ku përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit bëhet në respektim të kuadrit ligjor në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të çdo subjekti, duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve dhe duke respektuar integritetin akademik të tyre. (Evidenca 3.5: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë së UT; Evid. 3.10: Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH; Evid. 3.6: Manual i sigurimit të cilësisë; Evidenca 6.1 Paketa e Instrumenteve të NJSBC; Takimi i GVJ me drejtuesit e NJSBC).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Departamenti i gjuhës greke ka bashkëpunim institucional me Departamente të tjera analoge në Universitete Greke (Universiteti i Janinës, i Selanikut, i Korfuzit) Ky bashkëpunim ndikon në rritjen e cilësisë së programit të studimit dhe përmirësimin e saj. Bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm herë pas here bëjnë sugjerime në lidhje me programin e studimit dhe japin ekspertizë në lidhje me mbarëvajtjen e tij (Partneritetet e Departamentit; Takimi i GVJ me stafin akademik).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


<p><b>Standardi VI.5</b></p>	
<p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Krijimi i Kulturës së Brendshme të Cilësisë ndodhet në fokus të institucionit. Strategjia, politikat dhe procedurat e ndjekura nga Institucioni për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë publikohen në broshura dhe në faqen e internetit të FGJH, si edhe në faqen e institucionit (<a href="http://fgjh.edu.al/">http://fgjh.edu.al/</a>) (Evidenca 2.15). (Evidenca 1.5, Plani Strategjik i zhvillimit të FGJH; Evidenca 3.5: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë së UT; Evid. 3.10: Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH; Evid. 3.6: Manual i sigurimit të cilësisë)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Në bazë të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë (Evidenca 3.5), si dhe të VKM Nr. 531 / 11.09.2018 "PËR MIRATIMIN E KODIT TË CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË", Shtojca 2, Standardi VI.5, Kriteri Nr. 2, institucioni publikon rezultatet e vlerësimit në faqen e tij (<a href="http://fgjh.edu.al/">http://fgjh.edu.al/</a>), duke patur në vëmendje kërkesat ligjore mbi integritetin e personelit akademik, ruajtjen e të dhënave personale, promovimin e lirisë akademike dhe etikës akademike. (Evidenca 3.5: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë së UT; Evid.</p>





	3.10: RRregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FGJH; Evid. 3.6: Manual i sigurimit të cilësisë).			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit që dalin pas matjeve të ndryshme për kontrollin e cilësisë në Institucion u dërgohen instancave përkatëse të shoqëruara me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Ato përmbajnë sugjerime për aspektet që Departamenti mund të përmirësojë (sugjerimet zakonisht janë synime që mund të arrihen në vitet e ardhshme). Të dhënat përkatëse, të moderuara, publikohen edhe në raportin vjetor të institucionit ( <i>Aneks 3.14.1 "Raporti vjetor 2018-2019" dhe 3.14 Raporti i veprimtarisë mesimore kërkimore - shkencore për vitin 2020-2021; Evidenca 1.5, Plani Strategjik i zhvillimit të FGJH</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga dokumentacioni në dispozicion dhe vizita në Institucion, rezulton se Departamenti zhvillon takime të shpeshta me studentët apo koordinatorët e NJSBC, me fokus rritjen e informacionit mbi proceset e vlerësimit të cilësisë dhe rëndësinë e tyre dhe harton raporte vjetore, ku bëhet vlerësimi i efektivitetit dhe impaktit të veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, të cilat në vazhdim do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. ( <i>Evidenca 3.14: Raporti i veprimtarisë mesimore kërkimore -shkencore për vitin 2020-2021; Takimi i GVJ-së me stafin akademik, përgjegjësin e Departamentit</i> ).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti zhvillon mbledhje të përbashkëta të stafit akademik me studentët në fund të çdo simestri, për të bërë analizën e mbarëvajtjes së procesit didaktik dhe për të diskutuar problematikat që hasen gjatë kësaj periudhe si dhe masat për përmirësimin e pikave të dobëta të programit. Aty u bëhet e qartë studentëve dhe personelit akademik rëndësia e vlerësimit të cilësisë dhe të akreditimit të programit të studimit për mbarëvajtjen dhe suksesin e tij. ( <i>Takimi i GVJ-së me stafin akademik, përgjegjësin e Departamentit dhe studentët</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Gjuhë Greke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek, përkthim dhe interpretim” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranë.”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**


1. Brandi i Universitetit të Tiranës dhe historia e programit.
2. Bashkëpunime ndërkombëtare me Universitete të Greqisë.
3. Pavarësisht vetë-cilësimit absolut të institucionit, aftësia për të kuptuar dhe reflektuar mbi të gjithë pikat e mëposhtme me sinqeritet, dinjitet, pa pasion dhe sidomos idetë për t'i adresuar kanë bindur GVJ-në për aftësinë e institucionit për t'u përmirësuar në vazhdim të kësaj prove cilësie, të quajtur vlerësim për akreditim.
4. Përthithja e fondeve nga donatorë të jashtëm për aktivitete kërkimore, shkencore ose kulturore të Departamentit.
5. Infrastrukturë dhe pajisje teknologjike të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit.

**Pika të dobta:**

1. Mungesë dokumentimi të kompetencave përtej njohurive (*Standardi I.3, Kriteri 1, 3*).
2. Mungesë e një studimi të mirëfilltë të tregut të punës për këtë nivel studimi (*Standardi I.3, Kriteri 2*).
3. Ngarkesa mësimore tepër të larta për personelin akademik efektiv (*Standardi I.4, Kriteri 3*).
4. Koordinimi dhe mbikqyrja joefikase e (disa) lëndëve të ofruara nga departamente të tjera këtij programi të studimit (*Standardi I.5, Kriteri 1*).
5. Mungesa e praktikave dhe trajnimeve profesionale (*Standardi I.3, Kriteri 2*).
6. Shpërfillja për vite me radhë e detyrimeve ligjore për akreditim (*Standardi II.1, Kriteri 1*).
7. Pjesëmarrja e ulët e studentëve në pjesën e vizitës në institucion (*Standardi III.1, Kriteri 3*).
8. Mungesë e një strategjie për pasurimin e bibliotekës më tituj specifikë në shërbim të programit të studimit - Mungesë dokumentimi. (*Kriteret 4, 5. Standardi IV, 4*)
9. Nivel i ulët i përdorimit të bibliotekës ekzistuese. (*Kriteri 2, Standardi IV, 4*)

**Rekomandime:**

1. Propozojmë të realizohet një studim tregu për të identifikuar pikat e forta dhe sfidat e programit të studimit.
2. Sugjerojmë të rishikohen kurrikulat (dhe lidhjet e brendshme të lëndëve tangenciale), planet lëndore (ngarkesat e studentëve jashtë auditorit, kritere vlerësimi më të detajuara), regjimin e vlerësimit nëpër lëndë dhe testimet në to. Në këtë rishikim sugjerojmë të shikohen, përpos të tjerash në kuadrin e autonomisë akademike, mundësitë për:



- a. Akordimin e disa krediteve për praktika mësimore.
  - b. Rishikimin e vitit të ofrimit të disa lëndëve (p.sh. Hyrje në Komunikim).
  - c. Përfshirjen e disa lëndëve në fushën e TIK-ut, mbase edhe duke u përhapur me programe studimi në fushën e filologjisë dixhitale, proces në të cilin edhe universitetet partnerë mund të kontribuojnë.
3. Mendojmë se punësimi i personelit akademik me kontratë duhet të synojë me përparësi pedagogë me tituj apo grada.
  4. Shtimi i personelit akademik efektiv me përparësi pedagogë me tituj apo grada dhe akordimi i disa anëtarëve të personelit akademik efektiv në një drejtim kërkimor-shkencor.
  5. Motivimi dhe trajnimi i personelit akademik të botojë artikuj në revista të indeksuara dhe të rankuara në Clarivate Analytics (ish-Thomson/Reuters), ose SCOPUS, ose librash/kapitujsh në shtëpi botuese të rankuara në SENSE Academic Publishers.
  6. Mbikqyrja më e ngushtë e lëndëve që ofrohen nga personeli akademik nga departamente të tjera.
  7. Përditësimi i një udhëzuesi sistematik mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.
  8. Zgjerimin e sistemit të monitorimit të cilësisë edhe në mësimdhënien nga të barabartit (peer-review).
  9. Fuqizimi dhe trajnimi i studentëve për rolin e tyre në sigurimin e cilësisë dhe në aspekte të tjera të funksionimit institucional.
  10. Të hartohet një plan i mirëfinancuar për pasurimin e bibliotekës me libra dhe revista në trajtë fizike, por sidomos dixhitale.
  11. Sugjerohet të rishikohet afati për ankimimin e studentëve.
  12. Instalimi i një sistemi digjital menaxhimi të brendshëm i cili është shumë i nevojshëm sidomos për studentët në distance.

### Strengths and Affirmations:

1. The University of Tirana brand name and its history.
2. International collaborative provisions with Greek universities.
3. Regardless of the absolute self-assessment of the institution, its ability to appreciate and reflect on all of the following points with sincerity, dignity, without passion and ideas on how to address them have convinced the External Evaluation Group (EEG) about the ability of the institution to improve after this quality assessment exercise for accreditation.
4. Getting funds from external donors for scientific research and cultural activities of the Department.
5. Equipment and infrastructure appropriate for the development of the study programme.

### Weaknesses:

1. No competences beyond subject-specific knowledge are documented (*Standard I.3, Criteria 1 & 3*).
2. Absence of a specific study of the labour market for this study programme (*Standard I.3, Criterion 2*).
3. Excess teaching load borne by full-time academic staff (*Standard I.4, Criterion 3*).
4. Ineffective coordination and oversight of courses offered by other departments for this study programme (*Standard I.5, Criterion 1*).
5. Absence of internships and professional trainings (*Standard I.3, Criterion 2*).
6. Years-long indifference towards the legal obligation for accreditation (*Standard II.1, Criterion 1*).
7. Low participation rates of students in the on-site visit of the accreditation exercise (*Standard III.1, Criterion 3*).
8. No strategy for enriching the library with specific titles in service to the study programme (*Standard IV.4, Criteria 4 and 5*).
9. Low usage rate of existing Library (*Standard I.4, Criterion 2*).

### Recommendations:

1. We recommend that the Department conducts a labour market study to identify the study programme's strong points and challenges.
2. We suggest curriculum review (and review of the internal, tangential relations between courses), review of the syllabus (vis-à-vis student loads beyond auditorium and detailed assessment criteria), the assessment regime of subjects their tests. In this context, in the frame of academic autonomy we also suggest that the department looks at possibilities to:
  - a. Accord a number of credits for internships.

- b. Review the year certain subjects are offered (e.g., Intro to Communication).
  - c. The inclusion of some ICT-related courses, possibly extending with new study programmes to digital philology, in which process partner universities could also contribute.
3. We think that the appointment of full-time academic staff should target faculty with academic titles and terminal qualifications.
4. Enhancing full-time academic staff with staff with academic titles and terminal qualifications, as well as the designations of some academic staff members as staff oriented towards scientific research.
5. Motivating and training academic staff to publish articles in indexed journals, ranked in Clarivate Analytics (former Thomson-Reuters), or SCOPUS, or books/chapters published by publishers ranked in SENSE Academic Publishers.
6. Monitoring more closely the delivery of courses by other departments in this study programme.
7. Updating a systematic manual on the use and development of various methods of innovative teaching and learning.
8. Extending the quality assurance monitoring system to include peer-reviews.
9. Empowering and training students on their role in quality assurance and other aspect of institutional functioning.
10. Drafting a well-financed plan for the enrichment of the library with books and journals in hard or digital versions.
11. We suggest that the Department reviews the dead-line of filing student grievances.
12. Installing an internal digital management system, especially necessary for students living in distant places.

**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

